



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

RREGULLORE (ZKM)- NR.02/2025
PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E
VENDEVE TË PUNËS NË AGJENCINË PYJORE TË KOSOVËS¹

¹ Rregullore (ZKM)- nr.02/2025 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Pyjore të Kosovës, miratuar me Vendimin Nr.227/ 2025,të datës 05.03.2025

Kryeministri i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 94 paragrafi (3) i Kushtetutës së Kosovës, në pajtim me nenin 28 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (GZ,nr.7/01 mars 2019), dhe të nenit 9 të Rregullores (QRK) Nr.01/2020 për Standardet e Organizimit të Brendshëm, Sistematizimin e Vendeve të Punës dhe Bashkëpunimin në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Agjencitë e Pavarura,

Nxjerr:

RREGULLORE ZKM - NR.02/2025 PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË AGJENCINË PYJORE TË KOSOVËS

KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e organizimit të brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë Pyjore të Kosovës.

Neni 2 Fushëveprimi

1.Kjo Rregullore zbatohet për Agjencinë Pyjore të Kosovës.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë Pyjore të Kosovës, si agjenci ekzekutive e sistemit ministror-Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural janë përcaktuar me Ligjin Nr.08/L-137 për Pyjet- Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.9/3 Prill 2023 dhe legjisllacionin tjetër në fuqi.

KAPITULLI II ORGANIZIMI I BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMI I VENDEVE TË PUNËS NË AGJENCINË PYJORE TË KOSOVËS

Neni 3 Misioni i Agjencisë Pyjore të Kosovës

Agjencia Pyjore e Kosovës, bazuar në Ligjin Nr.08/L-137 për Pyjet (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.9/3 prill 2023), ka mision menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe tokave pyjore shtetërore, duke përfshirë kullotat dhe pyjet në parqet kombëtare si resurse me interes të përgjithshëm, asetet dhe infrastrukturën tjetër përcjellëse si dhe kujdeset për asetet e ish-

ndërmarrjeve sipas nenit 3, nen paragrafi 1.11 të këtij ligji, duke përfshirë edhe ndërtesat dhe objektet e tjera që janë pjesë e aseteve të këtyre ish - ndërmarrjeve shoqërore.

Neni 4

Struktura organizative në Agjencinë Pyjore të Kosovës

1. Struktura organizative në Agjencinë Pyjore të Kosovës është si në vijim:
 - 1.1. Zyra e Drejtorit Ekzekutiv;
 - 1.2. Departamentet, dhe
 - 1.3. Divizionet.
2. Numri i të punësuarve në Agjencinë Pyjore të Kosovës është katërqindë e njëzet e një (421).

Neni 5

Zyra e Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Kosovës

1. Zyra e Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Kosovës përbëhet nga:
 - 1.1. Drejtori Ekzekutiv;
 - 1.2. Stafi profesional dhe
 - 1.3. Stafi mbështetës.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Kosovës përcaktohen me ligjin përkatës për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe Agjencive të pavarura, Ligjit përkatës për Zyrarët Publik, Rregulloren përkatëse për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe legjisllacionit tjetër në fuqi.
3. Numri i të punësuarve në Zyrën e Drejtorit Ekzekutiv është pesë (5).

Neni 6

Departamentet dhe Divizionet e Agjencisë Pyjore të Kosovës,

1. Departamentet dhe Divizionet e Agjencisë Pyjore të Kosovës janë:
 - 1. Departamenti për Menaxhim me Pyje:**
 - 1.1. Divizioni për Inventarizim, Plane Menaxhuese dhe Kadastër Pyjor;
 - 1.2. Divizioni për Planifikim, Shfrytëzim dhe Kultivim të Pyjeve;

1.3. Divizioni për Menaxhimin e Informatave dhe të Dhënave Statistikore në Pylltari;

2. Departamenti për Menaxhimin me Vendgjueti me Rëndësi të Veçanta dhe Kultivimin e Kafshëve të Egra:

2.1. Divizioni për Menaxhimin e Vendgjuetive me Rëndësi të Veçanta;

2.2. Divizioni për Kultivimin e Kafshëve të Egra.

3. Departamenti Regjional i APK Prishtinë:

3.1. Divizioni për Mbrojtje dhe Ruajtje të Pyjeve;

3.2. Divizioni për Produktet Drunore, Jo drunore dhe Funkzionet tjera të Pyllit;

3.3. Divizioni për Ripërtrirje, Pyllëzime, Kullota dhe Këshillime.

4. Departamenti Regjional i APK Mitrovicë:

4.1. Divizioni për Mbrojtje dhe Ruajtje të Pyjeve;

4.2. Divizioni për Produktet Drunore, Jo drunore dhe Funkzionet tjera të Pyllit;

4.3. Divizioni për Ripërtrirje, Pyllëzime, Kullota dhe Këshillime.

5. Departamenti Regjional i APK Pejë:

5.1. Divizioni për Mbrojtje dhe Ruajtje të Pyjeve;

5.2. Divizioni për Produktet Drunore, Jo drunore dhe Funkzionet tjera të Pyllit;

5.3. Divizioni për Ripërtrirje, Pyllëzime, Kullota dhe Këshillime.

6. Departamenti Regjional i APK Prizren:

6.1. Divizioni për Mbrojtje dhe Ruajtje të Pyjeve;

6.2. Divizioni për Produktet Drunore, Jo drunore dhe Funkzionet tjera të Pyllit;

6.3. Divizioni për Ripërtrirje, Pyllëzime, Kullota dhe Këshillime.

7. Departamenti Regjional i APK Ferizaj:

7.1. Divizioni për Mbrojtje dhe Ruajtje të Pyjeve;

7.2. Divizioni për Produktet Drunore, Jo drunore dhe Funkcionet tjera të Pyllit;

7.3. Divizioni për Ripërtrirje, Pyllëzime, Kullota dhe Këshillime.

8. Departamenti Regjional i APK Gjilan:

8.1. Divizioni për Mbrojtje dhe Ruajtje të Pyjeve;

8.2. Divizioni për Produktet Drunore, Jo drunore dhe Funkcionet tjera të Pyllit;

8.3. Divizioni për Ripërtrirje, Pyllëzime, Kullota dhe Këshillime.

9. Departamenti Ligjor:

9.1. Divizioni për Mbështetje Ligjore;

9.2. Divizioni për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit.

10. Departamenti për Buxhet dhe Financa:

10.1. Divizioni për Buxhet;

10.2. Divizioni për Financa.

11. Departamenti i Shërbimeve të Përgjithshme:

11.1 Divizioni për Logjistikë dhe Shërbime;

11.2 Divizioni për Administrimin e Dokumenteve;

11.3. Divizioni për Teknologji Informative.

12. Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

13. Divizioni i Prokurimit dhe

14. Njësia e Auditimit të Brendshëm

Neni 7

Departamenti për Menaxhim me Pyje

1. Mision i Departamentit për Menaxhim me Pyje është menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve dhe tokave pyjore në bazë të parimit ekologjik, ekonomik dhe social në përputhje me kriteret ndërkombëtare për menaxhim të qëndrueshëm të pyjeve dhe sipas legjislacionit në fuqi.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit për Menaxhim me Pyje janë:
 - 2.1. Harton Planin Vjetor të Menaxhimit me Pyje;
 - 2.2. Dërgon planin vjetor të menaxhimit me pyje për komente tek komunat përkatëse në përputhje me dispozitat e parapara me ligjin për pyje;
 - 2.3. Harton planin për menaxhimin me pyje apo inicon procedurat për zhvillimin e projekteve përmes subjekteve të licencuara;
 - 2.4. Harton planin për menaxhim të qëndrueshëm dhe shumë qëllimor të pyjeve;
 - 2.5. Shqyrton vërejtjet, sugjerimet e marrura nga diskutimi publik dhe inkorporon të njëjtat në planin menaxhues me pyje;
 - 2.6. Monitoron zbatimin e Planit Vjetor të Menaxhimit me Pyje;
 - 2.7. Në koordinim me Departamentet Regjionale të APK-së, bën propozimin e projekteve kapitale për Kërkesën Buxhetore dhe Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve;
 - 2.8. Organizon dhe siguron zbatimimin e politikave të shfrytëzimit të qëndrueshëm të pyjeve dhe të strategjisë për zhvillimin e pylltarisë;
 - 2.9. Koordinon punën me Departamentet Regjionale të APK-së në planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve në pyje;
 - 2.10. Pas propozimit të Institutit të Pylltarisë inicon procedurën për marrjen e masave kundër sëmundjeve dhe dëmtuesve në pyje;
 - 2.11. Bën propozime dhe rekomandime për Drejtorin Ekzekutiv të APK-së për hartimin e planit të performancës dhe planeve tjera për arritjen e objektivave të institucionit;
 - 2.12. Koordinon punën me donatorë për projektet në sektorin e pylltarisë;
 - 2.13. Ushtron kërkesat për iniciimin e procedurave të projekteve të planifikuara sipas planit vjetor për menaxhim me pyje;
 - 2.14. Përgatitë dhe harton raporte nga aktivitetet në pyje për institucionet ndaj të cilave ka përgjegjësi raportuese;

2.15. Harton formularët unik për aktivitetet në pyje, toka pyjore dhe kullota.

3. Drejtori i Departamentit për Menaxhim me Pyje raporton tek Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Pyjore të Kosovës.

4. Numri i të punësuarve në Departamentin për Menaxhimin me Pyje është dymbëdhjetë (12).

Neni 8

Divizioni për Inventarizim, Plane Menaxhuese dhe Kadastër Pyjor

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Inventarizim, Plane Menaxhuese dhe Kadastër Pyjor janë:

1.1. Bën organizimin dhe përgatitjen e të gjitha kërkesave, termave të referencës dhe kriterëve për hartimin e inventarizimit të pyjeve si dhe planeve menaxhuese;

1.2. Shqyrton përputhshmërinë e planeve të shfrytëzimit të pyjeve me kapacitetet bazë të llogaritura nga Inventarizimi dhe Planet Menaxhuese;

1.3. Zbaton standardet dhe procedurat në planifikimin dhe shfrytëzimin e pyjeve, tokave pyjore dhe kullota;

1.4. Bën menaxhimin, mirëmbajtjen e kadastrit pyjor si dhe shfrytëzimin e të dhënave për aktivitetet e rregullta të APK-së;

1.5. Bën evidentimin e rrugëve pyjore në kadastrin pyjor dhe i përditëson ato;

1.6. Në koordinim me institucionet përgjegjëse mbanë shënimet mbi të gjitha elementet e kadastrit pyjor mirëmban dhe i përditëson ato;

1.7. Raporton në baza të rregullta për inventarizimin dhe planet menaxhuese pyjore;

1.8. Mbanë evidencën e realizimit të punimeve në pyje si dhe kronikën pyjore.

2. Udhëheqësi i Divizionit për Inventarizim, Plane Menaxhuese dhe Kadastër Pyjor raporton tek Drejtori i Departamentit për Menaxhim me Pyje.

3. Numri i të punësuarve në Divizionin për Inventarizim, Plane Menaxhuese dhe Kadastër Pyjor është tre (3).

Neni 9

Divizioni për Planifikim, Shfrytëzim dhe Kultivim të Pyjeve

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Planifikim dhe Shfrytëzim të Pyjeve janë:

- 1.1. Harton planet për shfrytëzimin e pyjeve dhe produkteve pyjore jo-drunore si: frutave pyjore, bimëve mjekuese dhe aromatike, këpurdhave, farërave dhe prodhimeve tjera duke përfshirë Parqet Kombëtare;
 - 1.2. Mbledhë dhe analizon rezultatet e implementimit të planeve në fushën përkatëse;
 - 1.3. Bën zbatimin e standardeve dhe procedurave në planifikimin dhe shfrytëzimin e pyjeve dhe tokave pyjore si dhe produkteve pyjore Jo drunore;
 - 1.4. Përcakton masat dhe standardet në vendosjen e rendit pyjor;
 - 1.5. Bën planifikimin, projektimin dhe mbikëqyrjen e rrugëve dhe infrastrukturës tjetër pyjore;
 - 1.6. Harton planin në nivel vendi për sanim të pyjeve të dëmtuara;
 - 1.7. Harton planet për parandalimin e zjarreve pyjore;
 - 1.8. Përcakton zonat dhe kuotat e mbledhjes në bazë të planeve menaxhuese shumë qëllimore të pyjeve, planeve të menaxhimit të pyjeve brenda parqeve kombëtare, programeve, projekteve për shfrytëzimin e PPJD-ve;
 - 1.9. Përgatitja e planeve vjetore në kultivim të pyjeve dhe realizimin e të njëjtave që kanë të bëjnë me çlirime, pastrime, rrallime, pyllëzime, ripyllëzime etj.;
 - 1.10. Bën planifikimin dhe monitorimin e aktiviteteve kultivuese dhe koordinon punët me Divizionet e Departamenteve Regjionale;
 - 1.11. Organizon dhe ofron këshilla për pronarët e pyjeve private;
 - 1.12. Mbikëqyr dhe zbaton planet për pyllëzimin e sipërfaqeve të zhveshura dhe planeve për ri kultivim, punimeve dhe shërbimeve pyjore në aktivitetet e pyllëzimeve, ripyllëzimeve, zëvendësimeve për të siguruar përmbushjen e standardeve profesionale;
 - 1.13. Harton raporte për të gjitha aktivitetet e realizuara në kultivim në të dy sektorët (privat dhe shtetëror);
 - 1.14. Bën plane për ripërtrijen dhe rikultivimin e pyjeve sipas planeve dhe programeve përkatëse.
2. Udhëheqësi i Divizionit për Planifikim, Shfrytëzim dhe Kultivim të Pyjeve raporton tek Drejtori i Departamentit për Menaxhim me Pyje.
 3. Numri i të punësuarve në Divizionin për Planifikim, Shfrytëzim dhe Kultivim të Pyjeve është pesë (5).

Neni 10

Divizioni për Menaxhimin e Informatave dhe të Dhënave Statistikore në Pylltari

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Menaxhimin e Informatave dhe të Dhënave Statistikore në Pylltari janë:

1.1. Harton raporte dhe analiza statistikore, periodike dhe vjetore në sektorin e pyjeve dhe kullotave;

1.2. Ofron mbështetje në hartimin e Planit Vjetor për Menaxhim me Pyje;

1.3. Ofron mbështetje në hartimin e strategjisë dhe të dokumenteve tjera afatmesme për pylltari si dhe në menaxhimin e informatave në tërësi për sektorin e pyjeve;

1.4. Bën azhurnimin e bazës së të dhënave të Sistemit Informativ të Pyjeve në Kosovë (SIPK), sa i përket pjesës profesionale të pylltarisë, programeve tjera në sektorin e pyjeve si dhe bën menaxhimin e informacionit që lidhen nga këto programe;

1.5. Bën përdorimin e Sistemit Kombëtar të informacionit për zjarret pyjore (NFFIS);

1.6. Mirëmban bazën e të dhënave mbi zjarret e pyjeve dhe ofron informata në përputhje me sistemin informativ Evropian për zjarre pyjore;

1.7. Bën evidencën e të gjitha punëve të kryera në pyje dhe toka pyjore dhe kullotave sipas afateve ligjore.

2. Udhëheqësi i Divizionit për Menaxhimin e Informatave dhe të Dhënave Statistikore në Pylltari raporton tek Drejtori i Departamentit për Menaxhim me Pyje.

3. Numri i të punësuarve në Divizionin për Menaxhimin e Informatave dhe të Dhënave Statistikore në Pylltari është tre (3).

Neni 11

DEPARTAMENTI PËR MENAXHIMIN ME VENDGJUETI ME RËNDËSI TË VEÇANTA DHE KULTIVIMIN E KAFSHËVE TË EGRA

1. Departamenti për Menaxhimin me Vendgjueti me Rëndësi të Veçanta dhe Kultivimin e Kafshëve të Egra ka mision menaxhimin me Vendgjueti me Rëndësi të Veçanta dhe Kultivimin e Kafshëve të Egra.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit për Menaxhim me Vendgjueti me Rëndësi të Veçanta dhe Kultivimin e Kafshëve të Egra janë:

2.1. Bën menaxhimin e vendgjuetive me rëndësi të veçanta;

2.2. Harton planet për menaxhimin e Vendgjuetive me Rëndësi të Veçanta;

2.3. Bën inventarizimin e kafshëve të egra në Vend Gjueti me Rëndësi të Veçanta;

2.4. Bën kultivimin e kafshëve të egra;

2.5. Mbledh përpunon dhe ruan të dhëna të faunës së egër dhe gjuetisë për MBPZHR përkatësisht Qeverinë e Republikës së Kosovës;

2.6. Harton plane për kultivimin e kafshëve të egra;

2.7. Cakton rregullat e vendgjuetive që janë të arsyeshme dhe të domosdoshme për mbrojtjen e pronës, shëndetit publik dhe sigurisë, dhe që mundësojnë përdorimin e drejtë të vendgjuetisë për gjah;

2.8. Cakton kushtet për lejimin e gjuetisë, përfshirë kufizimin e gjuetisë për kohë të caktuara, zona të caktuara, në lloje të caktuara, në kafshë të madhësisë, moshës ose gjinisë së caktuar, si dhe të kufizojnë përdorimin e mjeteve dhe metodave të caktuara në VGJRV;

2.9. Cakton tarifat e gjuajtjes për personat që lejohen të gjuajnë në Vend Gjueti me Rëndësi të Veçanta;

2.10. Cakton tarifa për shfrytëzimin e ndërtesave të ndërtuara për funksion të gjuetisë, që gjenden në Vend Gjueti me Rëndësi të Veçanta dhe shërbimet në to;

2.11. Organizon aktivitete të gjahut dhe ofron shërbime tjera gjahtarëve në Vendgjueti me Rëndësi të Veçanta;

2.12. Koordinon aktivitetet me të gjitha palët e interesit për zhvillimin e aktiviteteve në mbrojtjen e kafshëve të egra në lëmin e gjuetisë;

2.13. Harton (përgatit) formularët standard, ofron mbështetje dhe jep udhëzime lidhur me hartimin e raporteve periodike dhe vjetore për faunën e egër dhe gjuetinë;

2.14. Pranon kërkesa në pyje private, shqyrtimin e tyre si dhe lëshon leje për prerje brenda Vendgjuetive me Rëndësi të Veçanta;

2.15. Bën regjistrimin e rregullt vjetor të dëmeve në pyje publike brenda Vendgjuetive me Rëndësi të Veçanta.

3. Drejtori i Departamentit për Menaxhim me Vendgjueti me Rëndësi të Veçanta dhe Kultivimin e Kafshëve të Egra, raporton tek Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Pyjore të Kosovës.

4. Numri i të punësuarve në Departamentin për Menaxhim me Vendgjueti me Rëndësi të Veçanta dhe Kultivimin e Kafshëve të Egra është njëzet e nëntë (29).

Neni 12
Divizioni për Menaxhimin e Vendgjuetive me Rëndësi të Veçanta

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Menaxhimin e Vendgjuetive me Rëndësi të Veçanta janë:

1.1. Koordinon aktivitetet në nivel shtetëror me të gjitha palët e intersit për menaxhimin e kafshëve të egra;

1.2. Siguron organizimin e Shërbimit të Ruajtjes së Pyjeve dhe kafshëve të egra brenda Vendgjuetive me Rëndësi të Veçanta;

1.3. Mbledh, përpunon dhe ruan të dhëna për fanunën e egër dhe gjueti për MBPZHR përkatësisht Qeverinë e Republikës së Kosovës;

1.4. Propozon ngastra pyjore për shfrytëzim të pyjeve për përfshirje në planifikimin vjetor për menaxhimin me pyje brenda Vendgjuetive me Rëndësi të Veçanta;

1.5. Bën propozimin e planeve për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe tokave pyjore brenda Vendgjuetive me Rëndësi të Veçanta;

1.6. Pranon raporte periodike dhe vjetore nga menaxherët e të gjitha vendgjuetive (Vendgjueti me Rëndësi të Veçanta, Vendgjueti të Përbashkëta dhe Vendgjueti Private), bënë azhurnimin e të dhënave në Sistemin Informativ të Pyjeve të Kosovës (SIPK) në nivel shtetëror;

1.7. Harton planet menaxhuese afatgjate, vjetore dhe operacionale për Vendgjueti me Rëndësi të Veçanta;

1.8. Bën grumbullimin e të dhënave për numrin e kafshëve të egra dhe të dhënat tjera për gjendjen dhe kushteve të jetesës së kafshëve të egra;

1.9. Kujdeset dhe mirëmban infrastrukturën brenda Vendgjuetive me Rëndësi të Veçanta;

1.10. Bën menaxhimin e kullosave brenda Vendgjuetive me Rëndësi të Veçanta.

2. Udhëheqësi i Divizioni për Menaxhimin e Vendgjuetive me Rëndësi të Veçanta raporton tek Drejtori i Departamentit për Menaxhimin me Vendgjueti me Rëndësi të Veçanta dhe Kultivimin e Kafshëve të Egra.

3. Numri i të punësuarve në Divizionin për Menaxhimin e Vendgjuetive me Rëndësi të Veçanta është njëzet e pesë (25).

Neni 13
Divizioni për Kultivimin e Kafshëve të Egra

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Kultivimin e Kafshëve të Egra janë:

1.1.Bën kultivimin e kafshëve të egra;

1.2.Harton plane për kultivimin e kafshëve të egra;

1.3.Siguron dhe shpërndan ushqimin plotësues për kafshë të egra në Vendgjueti me Rëndësi të Veçanta;

1.4.Kujdeset për gjendjen shëndetësore të kafshëve të egra në Vendgjueti me Rëndësi të Veçanta;

1.5.Zhvillon procedurat dhe aktivitetet e gjuetisë brenda Vendgjuetive me Rëndësi të Veçanta;

1.6. Mbledh, përpunon dhe ruan të dhëna dhe informacione për MBPZHR, përkatësisht Qeverinë e Republikës së Kosovës, si dhe mbi bazën e tyre harton raporte dhe analiza statistikore për kultivimin e kafshëve të egra.

2. Udhëheqësi i Divizionit Kultivimin e Kafshëve të Egra raporton tek Drejtori i Departamentit për Menaxhimin me Vendgjueti me Rëndësi të Veçanta dhe Kultivimin e Kafshëve të Egra.

3. Numri i të punësuarve në Divizionin për Kultivimin e Kafshëve të Egra është tre (3).

Neni 14 DEPARTAMENTI REGJIONAL I APK NË PRISHTINË

1. Departamenti Regjional i APK-së në Prishtinë, ka për mision organizimin e shërbimit të ruajtjes dhe mbrojtjes së pyjeve, tokave pyjore, kullotave produkteve drunore, jodrunore, si dhe funksionet tjera të Pyllit në pronësi shtetërore për të siguruar zbatimimin e standardeve të shfrytëzimit të qëndrueshëm të pyjeve, tokave pyjore, kullotave në nivel regjioni në mënyrë që të përmbushin funksionet ekonomike, sociale dhe ekologjike sot, si dhe për të rritur potencialin prodhues, regjenerues dhe vitalitetin në të ardhmen.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit Regjional të APK-së në Prishtinë janë:

2.1. Organizon shërbimin e ruajtjes dhe mbrojtjes së pyjeve, tokave pyjore, kullotave në pronësi shtetërore në nivel regjioni;

2.2. Bën zbatimin e planeve për menaxhimin e pyjeve dhe tokave pyjore në nivel regjioni;

2.3. Zbaton standardet e përgjithshme për menaxhimin e qëndrueshëm të prodhimeve drusore, jo drusore dhe faunës së egër;

2.4. Propozon planet për zhvillimin e aktiviteteve në kultivimin, shfrytëzimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e pyjeve, tokave pyjore dhe kullotave;

2.5. Propozon ngastra pyjore për shfrytëzim të pyjeve për përfshirje në planifikimin vjetor për menaxhimin me pyje;

2.6. Bën propozimin e planeve për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve, tokave pyjore dhe kullotave;

2.7. Bën hartimin e planeve operacionale në nivel ngastre, apo nën ngastre pas miratimit të planit vjetor për menaxhim me pyje;

2.8. Kryen shërbimin e damkosjes në pyjet publike pas konfirmimit nga DMP për ngastrat dhe nën ngastrat e propozuara për planin vjetor;

2.9. Kryen shërbimin e punëve profesionale-teknike në pyjet private dhe lëshon lejen për prerje;

2.10. Ofron të dhëna për zbatimin e planeve në nivel regjioni;

2.11. Lëshon leje sipas tarifave të caktuara për shfrytëzimin e kullotave dhe bën inkasimin e mjeteve financiare.

3. Drejtori e Departamenteit Regjional të APK-së Prishtinë, raporton tek Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Pyjore të Kosovës.

4. Numri i të punësuarve në këtë Departament është pesëdhjetë e shtatë (57).

Neni 15

Divizioni për Mbrojtje dhe Ruajtje të Pyjeve

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Mbrojtje dhe ruajtje të pyjeve janë:

1.1. Planifikon, organizon dhe mbikëqyr kryerjen e punëve në sferën e mbrojtjes dhe ruajtjes së pyjeve nga faktorët biotik dhe abiotik në nivel regjional;

1.2. Zbaton masat për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve;

1.3. Propozon planet e mbrojtjes së pyjeve nga zjarret pyjore;

1.4. Siguron shërbimin për vëzhgim pyjor në pyjet të cilat klasifikohen si shumë të rrezikuara nga zjarri;

1.5. Vlerëson dëmet e shkaktuara nga zjarret si dhe dëmtues tjerë në pyje;

1.6. Ndërmerr masa ligjore për mbrojtjen e pyjeve, tokave pyjore dhe kullotave nga prejet ilegale të pyjeve, si dhe aktiviteteve tjera kundërligjore duke përfshirë edhe gjuetinë e paligjshme;

1.7. Bën vlerësimet- regjistrimet e rregullta vjetore dhe të jashtëzakonshme të dëmve pyjore, dëmet në tokat pyjore dhe kullosa;

1.8. Ndërmerr veprimet ligjore kundër personave fizikë dhe juridik të cilët kryjnë veprime kundërligjore duke sekuestruar masën drusore, mjetet dhe paisjet me të cilat është kryer vepra;

1.9. Siguron organizimin e Shërbimit të Ruajtjes së Pyjeve, tokave pyjore dhe kullotave;

1.10. Propozon planin për sanim të pyjeve të dëmtuara;

1.11. Koordinon punët me sektor tjerë në nivel të Departamenti Regjional dhe të APK-së në Qendër.

2. Udhëheqësi i Divizionit për Mbrojtje dhe Ruajtje të pyjeve raporton tek Drejtori i Departamentit Regjional të APK.

3. Numri i të punësuarve në Divizionet për Mbrojtje dhe ruajtje të pyjeve është dyzet e pesë (45).

Neni 16

Divizioni për Produktet Drunore, Jodrunore dhe Funkzionet tjera të Pyllit

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Produktet Drunore, Jodrunore dhe Funkzionet tjera të Pyllit janë:

1.1. Propozon plane për shfytëzimin e pyjeve;

1.2. Propozon planet vjetore dhe harton planet operacionale në nivel ngastre, njësie menaxhuese, komune dhe regjioni, duke përfshirë edhe pyjet në parqet kombëtare;

1.3. Aplikon të dhënat bazë të dala nga inventarizimi Kombëtar i pyjeve dhe kadastrit pyjor;

1.4. Bën mbikëqyrjen e zbatimit të kontratave nga sfera e shfrytëzimit të pyjeve dhe prodhimeve jo drunore pyjore, tokave pyjore dhe kullotave në nivel regjional;

1.5. Harton raporte në sferën e përgjegjësisë dhe raporton në nivelet kërkuese;

1.6. Koordinon punët me sektor tjerë në nivel të Departamentit Regjional dhe të APK-së në Qendër;

1.7. Bën propozimin e zonave të mbledhjes për planet menaxhuese shumë qëllimore të pyjeve për planet menaxhuese të pyjeve brenda parqeve kombëtare për programe dhe projekte për shfrytëzimin e PPJD-ve.

2. Udhëheqësi i Divizionit për Produktet Drunore, Jodrunore dhe Funkzionet tjera të Pyllit raporton tek Drejtori i Departamentit Regjional të APK-së.

3. Numri i të punësuarve në Divizionet Produktet Drunore, Jodrunore dhe Funkzionet tjera të Pyllit është pesë (5).

Neni 17 **Divizioni për Ripërtrirje, Pyllëzime, Kullota dhe Këshillime**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Ripërtrirje, Pyllëzime, Kullota dhe Këshillime janë:

1.1. Planifikon, organizon dhe mbikëqyr kryerjen e punëve në sferën e Kultivimit të Pyjeve;

1.2. Bën përzgjedhjen dhe damkosjen e trungjve për prerje në pyjet publike dhe private;

1.3. Propozon zhvillimin e aktiviteteve nga sfera e kultivimit të pyjeve, pyllëzimeve, mirëmbajtje të pyllëzimeve, prerje kujdesimi, grumbullim të farave pyjore dhe fidane për pyllëzime;

1.4. Bën propozimin për ripërtrirjen dhe rikultivimin e pyjeve;

1.5. Propozon plane për meliorimin dhe shfrytëzimin e kullotave;

1.6. Mbikëqyr zbatimin e aktiviteteve të projekteve, planeve dhe programeve, në lëminë e kultivimit të Pyjeve;

1.7. Harton raporte në sferën e përgjegjësiave dhe raporton në nivelet kërkuese;

1.8. Koordinon punët me sektor tjerë në nivel të Departamentit Regjional të APK-së dhe të APK-së në Qendër.

2. Udhëheqësi i Divizionit për Ripërtrirje, Pyllëzime, Kullota dhe Këshillime, raporton tek Drejtori i Departamentit Regjional të APK-së.

3. Numri i të punësuarve në Divizionet për Ripërtrirje, Pyllëzime, Kullota dhe Këshillime është gjashtë (6).

Neni 18
Departamenti Regjional i APK-së në Mitrovicë

1. Departamenti Regjional i APK-së në Mitrovicë ka për mision organizimin e shërbimit të ruajtjes dhe mbrojtjes së pyjeve, tokave pyjore, kullotave produkteve drunore, jodrunore si dhe funksionet tjera të Pyllit në pronësi shtetërore për të siguruar e zbatimimin e standardeve të shfrytëzimit të qëndrueshëm të pyjeve, tokave pyjore, kullotave në nivel regjioni në mënyrë që të përmbushin funksionet ekonomike, sociale dhe ekologjike sot si dhe për të rritur potencialin prodhues, regjenerues dhe vitalitetin në të ardhmen.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit Regjional të APK-së në Mitrovicë janë:

2.1. Organizon shërbimin e ruajtjes dhe mbrojtjes së pyjeve, tokave pyjore, kullotave në pronësi shtetërore në nivel regjioni;

2.2. Bën zbatimin e planeve për menaxhimin e pyjeve dhe tokave pyjore në nivel regjioni;

2.3. Zbaton standardet e përgjithshme për menaxhimin e qëndrueshëm të prodhimeve drusore, jo drusore dhe faunës së egër;

2.4. Propozon planet për zhvillimin e aktiviteteve në kultivimin, shfytëzimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e pyjeve, tokave pyjore dhe kullotave;

2.5. Propozon ngastra pyjore për shfrytëzim të pyjeve për përfshirje në planifikimin vjetor për menaxhimin me pyje;

2.6. Bën propozimin e planeve për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve, tokave pyjore dhe kullotave;

2.7. Bën hartimin e planeve operationele në nivel ngastre apo nën ngastre pas miratimit të planit vjetor për menaxhim me pyje.

2.8. Kryen shërbimin e damkosjes në pyjet publike pas konfirmimit nga DMP për ngastrat dhe nën ngastrat e propozuara për planin vjetor;

2.9. Kryen shërbimin e punëve profesionale-teknike në pyjet private dhe lëshon lejen për prerje;

2.10. Ofron të dhëna për zbatimin e planeve në nivel regjioni;

2.11. Lëshon leje sipas tarifave të caktuara për shfrytëzimin e kullotave dhe bën inkasimin e mjeteve financiare.

3. Drejtori e Departamentit Regjional të APK-së Mitrovicë raporton tek Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Pyjore të Kosovës.

4. Numri i të punësuarve në këtë Departament është pesëdhjetë e shtatë (57).

Neni 19
Divizioni për Mbrojtje dhe Ruajtje të Pyjeve

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Mbrojtje dhe ruajtje të pyjeve janë:

1.1. Planifikon, organizon dhe mbikëqyr kryerjen e punëve në sferën e mbrojtjes dhe ruajtjes së pyjeve nga faktorët biotik dhe abiotik në nivel regjional;

1.2. Zbaton masat për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve;

1.3. Propozon planet e mbrojtjes së pyjeve nga zjarret pyjore;

1.4. Siguron shërbimin për vëzhgim pyjor në pyjet të cilat klasifikohen si shumë të rrezikuara nga zjarri;

1.5. Vlerëson dëmet e shkaktuara nga zjarret si dhe dëmtues tjerë në pyje;

1.6. Ndërmerr masa ligjore për mbrojtjen e pyjeve, tokave pyjore dhe kullotave nga prejet ilegale në pyjeve si dhe aktivitetete tjera kundërligjore duke përfshirë edhe gjuetinë e paligjshme;

1.7. Bën vlerësimet- regjistrimet e rregullta vjetore dhe të jashtëzakonshme të dëmeve pyjore, dëmet në tokat pyjore dhe kullosa;

1.8. Ndërmerr veprimet ligjore kundër personave fizikë dhe juridik të cilët kryjnë veprime kundërligjore duke sekuestruar masën drusore, mjetet dhe paisjet me të cilat është kryer vepra;

1.9. Siguron organizimin e Shërbimit të Ruajtjes së Pyjeve, tokave pyjore dhe kullotave;

1.10. Propozon planin për sanim të pyjeve të dëmtuara;

1.11. Koordinon punët me sektor tjerë në nivel të Departamenti Regjional dhe të APK-së në Qendër.

2. Udhëheqësi i Divizionit për Mbrojtje dhe Ruajtje të pyjeve raporton tek Drejtori i Departamentit Regjional të APK-së.

3. Numri i të punësuarve në Divizionet për Mbrojtje dhe Ruajtje të pyjeve është dyzet e pesë (45).

Neni 20
Divizioni për Produktet Drunore, Jodrunore dhe Funkzionet tjera të Pyllit

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Produktet Drunore, Jodrunore dhe Funkzionet tjera të Pyllit janë:

- 1.1. Propozon plane për shfytëzimin e pyjeve;
- 1.2. Propozon planet vjetore dhe harton planet operacionale në nivel ngastre, njësie menaxhuese, komune dhe regjioni, duke përfshirë edhe pyjet në parqet kombëtare;
- 1.3. Aplikon të dhënat bazë të dala nga inventarizimi Kombëtar i pyjeve dhe kadastri pyjor;
- 1.4. Bën mbikëqyrjen e zbatimit të kontratave nga sfera e shfrytëzimit të pyjeve dhe prodhimeve jo drunore pyjore, tokave pyjore dhe kullotave në nivel regjional;
- 1.5. Harton raporte në sferën e përgjegjësiave dhe raporton në nivelet kërkuese;
- 1.6. Koordinon punët me sektor tjerë në nivel të Departamentit Regjional dhe të APK-së në Qendër;
- 1.7. Bën propozimin e zonave të mbledhjes për planet menaxhuese shumë qëllimore të pyjeve për planet menaxhuese të pyjeve brenda parqeve kombëtare për programe dhe projekte për shfrytëzimin e PPJD-ve.

2. Udhëheqësi i Divizionit për Produktet Drunore, Jodrunore dhe Funkzionet tjera të Pyllit raporton tek Drejtori i Departamentit Regjional të APK-së.

3. Numri i të punësuarve në Divizionet për Produktet Drunore, Jodrunore dhe Funkzionet tjera të Pyllit është pesë (5).

Neni 21
Divizioni për Ripërtrirje, Pyllëzime, Kullota dhe Këshillime

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Ripërtrirje, Pyllëzime, Kullota dhe Këshillime janë:

- 1.1. Planifikon, organizon dhe mbikëqyr kryerjen e punëve në sferën e Kultivimit të Pyjeve;
- 1.2. Bën përzgjedhjen dhe damkosjen trungjeve për prerje në pyjet publike dhe private;
- 1.3. Propozon zhvillimin e aktiviteteve nga sfera e kultivimit të pyjeve, pyllëzimeve, mirëmbajtje të pyllëzimeve, prerje kujdesimi, grumbullim të farave pyjore dhe fidane për pyllëzime;
- 1.4. Bën propozimin për ripërtrirjen dhe rikultivimin e pyjeve;

- 1.5. Propozon plane për meliorimin dhe shfrytëzimin e kullotave;
 - 1.6. Mbikëqyr zbatimin e aktiviteteve të projekteve, planeve dhe programeve, në lëminë e kultivimit të Pyjeve;
 - 1.7. Harton raporte në sferën e përgjegjësi dhe raporton në nivelet kërkuese;
 - 1.8. Koordinon punët me sektor tjerë në nivel të Departamentit Regjional të APK-së dhe të APK-së në Qendër.
2. Udhëheqësi i Divizionit për Ripërtrirje, Pyllëzime, Kullosa dhe Këshillime raporton tek Drejtori i Departamentit Regjional të APK-së.
 3. Numri i të punësuarve në Divizionet për Ripërtrirje, Pyllëzime, Kullosa dhe Këshillime është gjashtë (6).

Neni 22

Departamenti Regjional i APK-së në Pejë

1. Departamenti Regjional i APK-së në Pejë, ka për mision organizimin e shërbimit të ruajtjes dhe mbrojtjes së pyjeve, tokave pyjore, kullotave produkteve drunore, jodrunore si dhe funksionet tjera të Pyllit në pronësi shtetërore për të siguruar zbatimimin e standardeve të shfrytëzimit të qëndrueshëm të pyjeve, tokave pyjore, kullotave në nivel regjioni në mënyrë që të përmbushin funksionet ekonomike, sociale dhe ekologjike sot, si dhe për të rritur potencialin prodhues, regjenerues dhe vitalitetin në të ardhmen.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit Regjional të APK-së në Pejë janë:
 - 2.1. Organizon shërbimin e ruajtjes dhe mbrojtjes së pyjeve, tokave pyjore, kullotave në pronësi shtetërore në nivel regjioni;
 - 2.2. Bën zbatimin e planeve për menaxhimin e pyjeve dhe tokave pyjore në nivel regjioni;
 - 2.3. Zbaton standardet e përgjithshme për menaxhimin e qëndrueshëm të prodhimeve drusore, jo drusore dhe faunës së egër;
 - 2.4. Propozon planet për zhvillimin e aktiviteteve në kultivimin, shfrytëzimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e pyjeve, tokave pyjore dhe kullotave;
 - 2.5. Propozon ngastra pyjore për shfrytëzim të pyjeve për përfshirje në planifikimin vjetor për menaxhimin me pyje;
 - 2.6. Bën propozimin e planeve për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve, tokave pyjore dhe kullotave;

2.7. Bën hartimin e planeve operacionale në nivel ngastre apo nën ngastre pas miratimit të planit vjetor për menaxhim me pyje.

2.8. Kryen shërbimin e damkosjes në pyjet publike pas konfirmimit nga DMP për ngastrat dhe nën ngastrat e propozuara për planin vjetor;

2.9. Kryen shërbimin e punëve profesionale-teknike në pyjet private dhe lëshon lejen për prerje;

2.10. Ofron të dhëna për zbatimin e planeve në nivel regjioni;

2.11. Lëshon leje sipas tarifave të caktuara për shfrytëzimin e kullotave dhe bën inkasimin e mjeteve financiare.

3. Drejtori e Departamenteit Regjional të APK-së Pejë raporton tek Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Pyjore të Kosovës.

4. Numri i të punësuarve në këtë Departament është pesëdhjetë e tre (53).

Neni 23 **Divizioni për Mbrojtje dhe Ruajtje të Pyjeve**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Mbrojtje dhe Ruajtje të Pyjeve janë:

1.1. Planifikon, organizon dhe mbikëqyr kryerjen e punëve në sferën e mbrojtjes dhe ruajtjes së pyjeve nga faktorët biotik dhe abiotik në nivel regjional;

1.2. Zbaton masat për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve;

1.3. Propozon planet e mbrojtjes së pyjeve nga zjarret pyjore;

1.4. Siguron shërbimin për vëzhgim pyjor në pyjet të cilat klasifikohen si shumë të rrezikuara nga zjarri;

1.5. Vlerëson dëmet e shkaktuara nga zjarret si dhe dëmtues tjerë në pyje;

1.6. Ndërmerr masa ligjore për mbrojtjen e pyjeve, tokave pyjore dhe kullotave nga prejet ilegale në pyjeve si dhe aktivitetet tjera kundërligjore duke përfshirë edhe gjuetinë e paligjshme;

1.7. Bën vlerësimet- regjistrimet e rregullta vjetore dhe të jashtëzakonshme të dëmeve pyjore, dëmet në tokat pyjore dhe kullosa;

1.8. Ndërmerr veprimet ligjore kundër personave fizik dhe juridik të cilët kryjnë veprime kundërligjore duke sekuestruar masën drusore, mjetet dhe paisjet me të cilat është kryer vepra;

1.9. Siguron organizimin e Shërbimit të Ruajtjes së Pyjeve, tokave pyjore dhe kullotave;

1.10. Propozon planin për sanim të pyjeve të dëmtuara;

1.11. Koordinon punët me sektor tjerë në nivel të Departamentit Regjional dhe të APK-së në Qendër.

2. Udhëheqësi i Divizionit për Mbrojtje dhe Ruajtje të pyjeve raporton tek Drejtori i Departamentit Regjional të APK-së.

3. Numri i të punësuarve në Divizionet për Mbrojtje dhe ruajtje të pyjeve është dyzet e një (41).

Neni 24

Divizioni për Produktet Drunore, Jodrunore dhe Funkcionet tjera të Pyllit

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Produktet Drunore, Jodrunore dhe Funkcionet tjera të Pyllit janë:

1.1. Propozon plane për shfytëzimin e pyjeve;

1.2. Propozon planet vjetore dhe harton planet operacionale në nivel ngastre, njësie menaxhuese, komune dhe regjioni, duke përfshirë edhe pyjet në qarqet kombëtare;

1.3. Aplikon të dhënat bazë të dala nga inventarizimi Kombëtar i pyjeve dhe kadastrin pyjor;

1.4. Bën mbikëqyrjen e zbatimit të kontratave nga sfera e shfrytëzimit të pyjeve dhe prodhimeve jo drunore pyjore, tokave pyjore dhe kullotave në nivel regjional;

1.5. Harton raporte në sferën e përgjegjësisë dhe raporton në nivelet kërkuese;

1.6. Koordinon punët me sektor tjerë në nivel të Departamentit Regjional dhe të APK-së në Qendër;

1.7. Bën propozimin e zonave të mbledhjes për planet menaxhuese shumë qëllimore të pyjeve për planet menaxhuese të pyjeve brenda qarqeve kombëtare për programe dhe projekte për shfrytëzimin e PPJD-ve.

2. Udhëheqësi i Divizionit për Produktet Drunore, Jodrunore dhe Funkcionet tjera të Pyllit raporton tek Drejtori i Departamentit Regjional të APK-së.

3. Numri i të punësuarve në Divizionet për Produktet Drunore, Jodrunore dhe Funkcionet tjera të Pyllit është pesë (5).

Neni 25
Divizioni për Ripërtrirje, Pyllëzime, Kullota dhe Këshillime

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Ripërtrirje, Pyllëzime, Kullota dhe Këshillime janë:

1.1. Planifikon, organizon dhe mbikëqyr kryerjen e punëve në sferën e Kultivimit të Pyjeve;

1.2. Bën përzgjedhjen dhe damkosjen trunqjve për prerje në pyjet publike dhe private;

1.3. Propozon zhvillimin e aktiviteteve nga sfera e kultivimit të pyjeve, pyllëzimeve, mirëmbajtje të pyllëzimeve, prerje kujdesimi, grumbullim të farave pyjore dhe fidane për pyllëzime;

1.4. Bën propozimin për ripërtrirjen dhe rikultivimin e pyjeve;

1.5. Propozon plane për meliorimin dhe shfrytëzimin e kullotave;

1.6. Mbikëqyr zbatimin e aktiviteteve të projekteve, planeve dhe programeve në lëminë e kultivimit të Pyjeve;

1.7. Harton raporte në sferën e përgjegjësisë dhe raporton në nivelet kërkuese;

1.8. Koordinon punët me sektorë tjerë në nivel të Departamentit Regjional të APK-së dhe të APK-së në Qendër.

2. Udhëheqësi i Divizionit për Ripërtrirje, Pyllëzime, Kullota dhe Këshillime raporton tek Drejtori i Departamentit Regjional të APK-së.

3. Numri i të punësuarve në Divizionet për Ripërtrirje, Pyllëzime, Kullota dhe Këshillime është gjashtë (6).

Neni 26
Departamenti Regjional i APK-së në Ferizaj

1. Departamenti Regjional i APK-së në Ferizaj ka për mision organizimin e shërbimit të ruajtjes dhe mbrojtjes së pyjeve, tokave pyjore, kullotave, produkteve drunore, jodrunore, si dhe funksionet tjera të Pyllit në pronësi shtetërore për të siguruar zbatimimin e standardeve të shfrytëzimit të qëndrueshëm të pyjeve, tokave pyjore, kullotave në nivel regjioni në mënyrë që të përmbushin funksionet ekonomike, sociale dhe ekologjike sot, si dhe për të rritur potencialin prodhues, regjenerues dhe vitalitetin në të ardhmen.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit Regjional të APK-së në Ferizaj janë:

2.1. Organizon shërbimin e ruajtjes dhe mbrojtjes së pyjeve, tokave pyjore, kullotave në pronësi shtetërore në nivel regjioni;

- 2.2. Bën zbatimin e planeve për menaxhimin e pyjeve dhe tokave pyjore në nivel regjioni;
 - 2.3. Zbaton standardet e përgjithshme për menaxhimin e qëndrueshëm të prodhimeve drusore, jodrusore dhe faunës së egër;
 - 2.4. Propozon planet për zhvillimin e aktiviteteve në kultivimin, shfytëzimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e pyjeve, tokave pyjore dhe kullotave;
 - 2.5. Propozon ngastra pyjore për shfrytëzim të pyjeve për përfshirje në planifikimin vjetor për menaxhimin me pyje;
 - 2.6. Bën propozimin e planeve për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve, tokave pyjore dhe kullotave;
 - 2.7. Bën hartimin e planeve operacionale në nivel ngastre apo nën ngastre pas miratimit të planit vjetor për menaxhim me pyje;
 - 2.8. Kryen shërbimin e damkosjes në pyjet publike pas konfirmimit nga DMP për ngastrat dhe nën ngastrat e propozuara për planin vjetor;
 - 2.9. Kryen shërbimin e punëve profesionale-teknike në pyjet private dhe lëshon lejen për prerje;
 - 2.10. Ofron të dhëna për zbatimin e planeve në nivel regjioni;
 - 2.11. Lëshon leje sipas tarifave të caktuara për shfrytëzimin e kullotave dhe bën inkasimin e mjeteve financiare.
3. Drejtori e Departamenteit Regjional të APK-së Ferizaj raporton tek Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Pyjore të Kosovës.
4. Numri i të punësuarve në këtë Departament është pesëdhjetë e tre (53).

Neni 27
Divizioni për Mbrojtje dhe Ruajtje të Pyjeve

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Mbrojtje dhe Ruajtje të Pyjeve janë:
 - 1.1. Planifikon, organizon dhe mbikëqyr kryerjen e punëve në sferën e mbrojtjes dhe ruajtjes së pyjeve nga faktorët biotik dhe abiotik në nivel regjional;
 - 1.2. Zbaton masat për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve;
 - 1.3. Propozon planet e mbrojtjes së pyjeve nga zjarret pyjore;

1.4. Siguron shërbimin për vëzhgim pyjor në pyjet të cilat klasifikohen si shumë të rrezikuara nga zjarri;

1.5. Vlerëson dëmet e shkaktuara nga zjarret si dhe dëmtues tjerë në pyje;

1.6. Ndërmerr masa ligjore për mbrojtjen e pyjeve, tokave pyjore dhe kullotave nga prejet ilegale në pyjeve, si dhe aktiviteteve tjera kundërligjore duke përfshirë edhe gjuetinë e paligjshme;

1.7. Bën vlerësimet- regjistrimet e rregullta vjetore dhe të jashtëzakonshme të dëmve pyjore, dëmet në tokat pyjore dhe kullosa;

1.8. Ndërmerr veprimet ligjore kundër personave fizik dhe juridik të cilët kryjnë veprime kundërligjore duke sekuestruar masën drusore, mjetet dhe paisjet me të cilat është kryer vepra;

1.9. Siguron organizimin e Shërbimit të Ruajtjes së Pyjeve, tokave pyjore dhe kullotave;

1.10. Propozon planin për sanim të pyjeve të dëmtuara;

1.11. Koordinon punët me sektor tjerë në nivel të Departamentit Regjional dhe të APK-së në Qendër.

2. Udhëheqësi i Divizionit për Mbrojtje dhe Ruajtje të pyjeve raporton tek Drejtori i Departamentit Regjional të APK-së.

3. Numri i të punësuarve në Divizionet për Mbrojtje dhe ruajtje të pyjeve është dyzet e një (41).

Neni 28

Divizioni për Produktet Drunore, Jodrunore dhe Funkzionet tjera të Pyllit

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Produktet Drunore, Jodrunore dhe Funkzionet tjera të Pyllit janë:

1.1. Propozon plane për shfytëzimin e pyjeve;

1.2. Propozon planet vjetore dhe harton planet operationale në nivel ngastre, njësie menaxhuese, komune dhe regjioni, duke përfshirë edhe pyjet në parqet kombëtare;

1.3. Aplikon të dhënat bazë të dala nga inventarizimi Kombëtar i pyjeve dhe kadastri pyjor;

1.4. Bën mbikëqyrjen e zbatimit të kontratave nga sfera e shfrytëzimit të pyjeve dhe prodhimeve jo drunore pyjore, tokave pyjore dhe kullotave në nivel regjional;

1.5. Harton raporte në sferën e përgjegjësisë dhe raporton në nivelet kërkuese;

1.6. Koordinon punët me sektor tjerë në nivel të Departamentit Regjional dhe të APK-së në Qendër;

1.7. Bën propozimin e zonave të mbledhjes për planet menaxhuese shumë qëllimore të pyjeve për planet menaxhuese të pyjeve brenda parqeve kombëtare për programe dhe projekte për shfrytëzimin e PPJD-ve.

2. Udhëheqësi i Divizionit për Produktet Drunore, Jodrunore dhe Funkcionet tjera të Pyllit raporton tek Drejtori i Departamentit Regjional të APK-së.

3. Numri i të punësuarve në Divizionet Produktet Drunore, Jodrunore dhe Funkcionet tjera të Pyllit është pesë (5).

Neni 29

Divizioni për Ripërtrirje, Pyllëzime, Kullota dhe Këshillime

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Ripërtrirje, Pyllëzime, Kullota dhe Këshillime janë:

1.1. Planifikon, organizon dhe mbikëqyr kryerjen e punëve në sferën e Kultivimit të Pyjeve;

1.2. Bën përzgjedhjen dhe damkosjen trugjve për prerje në pyjet publike dhe private;

1.3. Propozon zhvillimin e aktiviteteve nga sfera e kultivimit të pyjeve, pyllëzimeve, mirëmbajtje të pyllëzimeve, prerje kujdesimi, grumbullim të farave pyjore dhe fidane për pyllëzime;

1.4. Bën propozimin për ripërtrirjen dhe rikultivimin e pyjeve;

1.5. Propozon plane për meliorimin dhe shfrytëzimin e kullotave;

1.6. Mbikëqyrë zbatimin e aktiviteteve të projekteve, planeve dhe programeve, në lëminë e kultivimit të Pyjeve;

1.7. Harton raporte në sferën e përgjegjësisë dhe raporton në nivelet kërkuese.

1.8. Koordinon punët me sektor tjerë në nivel të Departamentit Regjional të APK-së dhe të APK-së në Qendër.

2. Udhëheqësi i Divizionit për Ripërtrirje, Pyllëzime, Kullota dhe Këshillime raporton tek Drejtori i Departamentit Regjional të APK-së.

3. Numri i të punësuarve në Divizionet për Ripërtrirje, Pyllëzime, Kullota dhe Këshillime është gjashtë (6).

Neni 30
Departamenti Regjional i APK-së në Prizren

1. Departamenti Regjional i APK-së në Prizren ka për mision organizimin e shërbimit të ruajtjes dhe mbrojtjes së pyjeve, tokave pyjore, kullotave produkteve drunore, jodrunore si dhe funksionet tjera të Pyllit në pronësi shtetërore për të siguruar e zbatimimin e standardeve të shfrytëzimit të qëndrueshëm të pyjeve, tokave pyjore, kullotave në nivel regjioni në mënyrë që të përmbushin funksionet ekonomike, sociale dhe ekologjike sot, si dhe për të rritur potencialin prodhues, regjenerues dhe vitalitetin në të ardhmen.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit Regjional të APK-së në Prizren janë:

2.1. Organizon shërbimin e ruajtjes dhe mbrojtjes së pyjeve, tokave pyjore, kullotave në pronësi shtetërore në nivel regjioni;

2.2. Bën zbatimin e planeve për menaxhimin e pyjeve dhe tokave pyjore në nivel regjioni;

2.3. Zbaton standardet e përgjithshme për menaxhimin e qëndrueshëm të prodhimeve drusore, jo drusore dhe faunës së egër;

2.4. Propozon planet për zhvillimin e aktiviteteve në kultivimin, shfytëzimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e pyjeve, tokave pyjore dhe kullotave;

2.5. Propozon ngastra pyjore për shfrytëzim të pyjeve për përfshirje në planifikimin vjetor për menaxhimin me pyje;

2.6. Bën propozimin e planeve për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve, tokave pyjore dhe kullotave;

2.7. Bën hartimin e planeve operacionale në nivel ngastre apo nën ngastre pas miratimit të planit vjetor për menaxhim me pyje.

2.8. Kryen shërbimin e damkosjes në pyjet publike pas konfirmimit nga DMP për ngastrat dhe nën ngastrat e propozuara për planin vjetor;

2.9. Kryen shërbimin e punëve profesionale-teknike në pyjet private dhe lëshon lejen për prerje;

2.10. Ofron të dhëna për zbatimin e planeve në nivel regjioni;

2.11. Lëshon leje sipas tarifave të caktuara për shfrytëzimin e kullotave dhe bën inkasimin e mjeteve financiare.

3. Drejtoria e Departamenteit Regjional të APK-së Prizren raporton tek Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Pyjore të Kosovës.

4. Numri i të punësuarve në këtë Departament është pesëdhjetë e shtatë (57).

Neni 31
Divizioni për Mbrojtje dhe Ruajtje të Pyjeve

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Mbrojtje dhe ruajtje të pyjeve janë:

1.1. Planifikon, organizon dhe mbikëqyr kryerjen e punëve në sferën e mbrojtjes dhe ruajtjes së pyjeve nga faktorët biotik dhe abiotik në nivel regjional;

1.2. Zbaton masat për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve;

1.3. Propozon planet e mbrojtjes së pyjeve nga zjarret pyjore;

1.4. Siguron shërbimin për vëzhgim pyjor në pyjet të cilat klasifikohen si shumë të rrezikuara nga zjarri;

1.5. Vlerëson dëmet e shkaktuara nga zjarret si dhe dëmtues tjerë në pyje;

1.6. Ndërmerr masa ligjore për mbrojtjen e pyjeve, tokave pyjore dhe kullotave nga prerjet ilegale të pyjeve si dhe aktiviteteve tjera kundërligjore duke përfshirë edhe gjuetinë e paligjshme;

1.7. Bën vlerësimet- regjistrimet e rregullta vjetore dhe të jashtëzakonshme të dëmeve pyjore, dëmet në tokat pyjore dhe kullosa;

1.8. Ndërmerr veprimet ligjore kundër personave fizikë dhe juridik të cilët kryjnë veprime kundërligjore duke sekuestruar masën drusore, mjetet dhe paisjet me të cilat është kryer vepra;

1.9. Siguron organizimin e Shërbimit të Ruajtjes së Pyjeve, tokave pyjore dhe kullotave;

1.10. Propozon planin për sanim të pyjeve të dëmtuara;

1.11. Koordinon punët me sektor tjerë në nivel të Departamenti Regjional dhe të APK-së në Qendër.

2. Udhëheqësi i Divizionit për Mbrojtje dhe Ruajtje të pyjeve raporton tek Drejtori i Departamentit Regjional të APK-së.

3. Numri i të punësuarve në Divizionet për Mbrojtje dhe ruajtje të pyjeve është dyzet e pesë (45).

Neni 32
Divizioni për Produktet Drunore, Jodrunore dhe Funkzionet tjera të Pyllit

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Produktet Drunore, Jodrunore dhe Funkzionet tjera të Pyllit janë:

- 1.1. Propozon plane për shfytëzimin e pyjeve;
- 1.2. Propozon planet vjetore dhe harton planet operacionale në nivel ngastre, njësie menaxhuese, komune dhe regjioni, duke përfshirë edhe pyjet në parqet kombëtare;
- 1.3. Aplikon të dhënat bazë të dala nga inventarizimi Kombëtar i pyjeve dhe kadastri pyjor;
- 1.4. Bën mbikëqyrjen e zbatimit të kontratave nga sfera e shfrytëzimit të pyjeve dhe prodhimeve jo drunore pyjore, tokave pyjore dhe kullotave në nivel regjional;
- 1.5. Harton raporte në sferën e përgjegjësisë dhe raporton në nivelet kërkuese;
- 1.6. Koordinon punët me sektor tjerë në nivel të Departamentit Regjional dhe të APK-së në Qendër;
- 1.7. Bën propozimin e zonave të mbledhjes për planet menaxhuese shumë qëllimore të pyjeve për planet menaxhuese të pyjeve brenda parqeve kombëtare për programe dhe projekte për shfrytëzimin e PPJD-ve.

2. Udhëheqësi i Divizionit për Produktet Drunore, Jodrunore dhe Funkzionet tjera të Pyllit raporton tek Drejtori i Departamentit Regjional të APK-së.

3. Numri i të punësuarve në Divizionet Produktet Drunore, Jodrunore dhe Funkzionet tjera të Pyllit është pesë (5).

Neni 33
Divizioni për Ripërtrirje, Pyllëzime, Kullota dhe Këshillime

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Ripërtrirje, Pyllëzime, Kullosa dhe Këshillime janë:

- 1.1. Planifikon, organizon dhe mbikëqyr kryerjen e punëve në sferën e Kultivimit të Pyjeve;
- 1.2. Bën përzgjedhjen dhe damkosjen e trungjeve për prerje në pyjet publike dhe private;
- 1.3. Propozon zhvillimin e aktiviteteve nga sfera e kultivimit të pyjeve, pyllëzimeve, mirëmbajtje të pyllëzimeve, prerje kujdesimi, grumbullim të farave pyjore dhe fidane për pyllëzime;
- 1.4. Bën propozimin për ripërtrirjen dhe rikultivimin e pyjeve;

- 1.5. Propozon plane për meliorimin dhe shfrytëzimin e kullotave;
 - 1.6. Mbikëqyrë zbatimin e aktiviteteve të projekteve, planeve dhe programeve, në lëminë e kultivimit të Pyjeve;
 - 1.7. Harton raporte në sferën e përgjegjësisë dhe raporton në nivelet kërkuese.
 - 1.8. Koordinon punët me sektor tjerë në nivel të Departamentit Regjional të APK-së dhe të APK-së në Qendër.
2. Udhëheqësi i Divizionit për Ripërtrirje, Pyllëzime, Kullosa dhe Këshillime raporton tek Drejtori i Departamentit Regjional të APK-së.
 3. Numri i të punësuarve në Divizionet për Ripërtrirje, Pyllëzime, Kullosa dhe Këshillime është gjashtë (6).

Neni 34

Departamenti Regjional i APK-së në Gjilan

1. Departamenti Regjional i APK-së në Gjilan ka për mision organizimin e shërbimit të ruajtjes dhe mbrojtjes së pyjeve, tokave pyjore, kullotave produkteve drunore, jodrunore si dhe funksionet tjera të Pyllit në pronësi shtetërore për të siguruar e zbatimimin e standardeve të shfrytëzimit të qëndrueshëm të pyjeve, tokave pyjore, kullotave në nivel regjioni në mënyrë që të përmbushin funksionet ekonomike, sociale dhe ekologjike sot si dhe për të rritur potencialin prodhues, regjenerues dhe vitalitetin në të ardhmen.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit Regjional të APK-së në Gjilan janë:
 - 2.1. Organizon shërbimin e ruajtjes dhe mbrojtjes së pyjeve, tokave pyjore, kullotave në pronësi shtetërore në nivel regjioni;
 - 2.2. Bën zbatimin e planeve për menaxhimin e pyjeve dhe tokave pyjore në nivel regjioni;
 - 2.3. Zbaton standardet e përgjithshme për menaxhimin e qëndrueshëm të prodhimeve drunore, jo drunore dhe faunës së egër;
 - 2.4. Propozon planet për zhvillimin e aktiviteteve në kultivimin, shfrytëzimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e pyjeve, tokave pyjore dhe kullotave;
 - 2.5. Propozon ngastra pyjore për shfrytëzim të pyjeve për përfshirje në planifikimin vjetor për menaxhimin me pyje;
 - 2.6. Bën propozimin e planeve për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve, tokave pyjore dhe kullotave;
 - 2.7. Bën hartimin e planeve operationale në nivel ngastre apo nën ngastre pas miratimit të planit vjetor për menaxhim me pyje.

2.8. Kryen shërbimin e damkosjes në pyjet publike pas konfirmimit nga DMP për ngastrat dhe nën ngastrat e propozuara për planin vjetor;

2.9. Kryen shërbimin e punëve profesionale-teknike në pyjet private dhe lëshon lejen për prerje;

2.10. Ofron të dhëna për zbatimin e planeve në nivel regjioni;

2.11. Lëshon leje sipas tarifave të caktuara për shfrytëzimin e kullotave dhe bën inkasimin e mjeteve financiare.

3. Drejtori e Departamenteit Regjional të APK-së Gjilan raporton tek Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Pyjore të Kosovës.

4. Numri i të punësuarve në këtë Departament është pesëdhjetë e shtatë (57).

Neni 35 **Divizioni për Mbrojtje dhe Ruajtje të Pyjeve**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Mbrojtje dhe ruajtje të pyjeve janë:

1.1. Planifikon, organizon dhe mbikëqyr kryerjen e punëve në sferën e mbrojtjes dhe ruajtjes së pyjeve nga faktorët biotik dhe abiotik në nivel regjional;

1.2. Zbaton masat për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve;

1.3. Propozon planet e mbrojtjes së pyjeve nga zjarret pyjore;

1.4. Siguron shërbimin për vëzhgim pyjor në pyjet të cilat klasifikohen si shumë të rrezikuara nga zjarri;

1.5. Vlerëson dëmet e shkaktuara nga zjarret si dhe dëmtues tjerë në pyje;

1.6. Ndërmerr masa ligjore për mbrojtjen e pyjeve, tokave pyjore dhe kullotave nga prejet ilegale të pyjeve si dhe aktiviteteve tjera kundërligjore duke përfshirë edhe gjuetinë e paligjshme;

1.7. Bën vlerësimet- regjistrimet e rregullta vjetore dhe të jashtëzakonshme të dëmvë pyjore, dëmet në tokat pyjore dhe kullosa;

1.8. Ndërmerr veprimet ligjore kundër personave fizik dhe juridik të cilët kryjnë veprime kundërligjore duke sekuestruar masën drusore, mjetet dhe paisjet me të cilat është kryer vepra;

1.9. Siguron organizimin e Shërbimit të Ruajtjes së Pyjeve, tokave pyjore dhe kullotave;

1.10. Propozon planin për sanim të pyjeve të dëmtuara;

1.11. Koordinon punët me sektor tjerë në nivel të Departamenti Regjional dhe të APK-së në Qendër.

2. Udhëheqësi i Divizionit për Mbrojtje dhe Ruajtje të për pyjeve raporton tek Drejtori i Departamentit Regjional të APK-së.

3. Numri i të punësuarve në Divizionet për Mbrojtje dhe ruajtje të pyjeve është dyzetë e pesë (45).

Neni 36

Divizioni për Produktet Drunore, Jodrunore dhe FunkSIONet tjera të Pyllit

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Produktet Drunore, Jodrunore dhe FunkSIONet tjera të Pyllit janë:

1.1. Propozon plane për shfytëzimin e pyjeve;

1.2. Propozon planet vjetore dhe harton planet operacionale në nivel ngastre, njësie menaxhuese, komune dhe regjioni, duke përfshirë edhe pyjet në parqet kombëtare;

1.3. Aplikon të dhënat bazë të dala nga inventarizimi Kombëtar i pyjeve dhe kadastri pyjor;

1.4. Bën mbikëqyrjen e zbatimit të kontratave nga sfera e shfrytëzimit të pyjeve dhe prodhimeve jo drunore pyjore, tokave pyjore dhe kullotave në nivel regjional;

1.5. Harton raporte në sferën e përgjegjësisë dhe raporton në nivelet kërkuese;

1.6. Koordinon punët me sektor tjerë në nivel të Departamentit Regjional dhe të APK-së në Qendër;

1.7. Bën propozimin e zonave të mbledhjes për planet menaxhuese shumë qëllimore të pyjeve për planet menaxhuese të pyjeve brenda parqeve kombëtare për programe dhe projekte për shfrytëzimin e PPJD-ve.

2. Udhëheqësi i Divizionit për Produktet Drunore, Jodrunore dhe FunkSIONet tjera të Pyllit raporton tek Drejtori i Departamentit Regjional të APK-së.

3. Numri i të punësuarve në Divizionet Produktet Drunore, Jodrunore dhe FunkSIONet tjera të Pyllit është pesë (5).

Neni 37

Divizioni për Ripërtrirje, Pyllëzime, Kullota dhe Këshillime

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Ripërtrirje, Pyllëzime, Kullota dhe Këshillime janë:

1.1. Planifikon, organizon dhe mbikëqyr kryerjen e punëve në sferën e Kultivimit të Pyjeve;

1.2. Bën përzgjedhjen dhe damkosjen trunqeve për prerje në pyjet publike dhe private;

1.3. Propozon zhvillimin e aktiviteteve nga sfera e kultivimit të pyjeve, pyllëzimeve, mirëmbajtje të pyllëzimeve, prerje kujdesimi, grumbullim të farave pyjore dhe fidane për pyllëzime;

1.4. Bën propozimin për ripërtritjen dhe rikultivimin e pyjeve;

1.5. Propozon plane për meliorimin dhe shfrytëzimin e kullotave;

1.6. Mbikëqyr zbatimin e aktiviteteve të projekteve, planeve dhe programeve, në lëminë e kultivimit të Pyjeve;

1.7. Harton raporte në sferën e përgjegjësive dhe raporton në nivelet kërkuese;

1.8. Koordinon punët me sektor tjerë në nivel të Departamentit Regjional të APK-së dhe të APK-së në Qendër.

2. Udhëheqësi i Divizionit për Ripërtrirje, Pyllëzime, Kullosa dhe Këshillime raporton tek Drejtori i Departamentit Regjional të APK-së.

3. Numri i të punësuarve në Divizionet për Ripërtrirje, Pyllëzime, Kullosa dhe Këshillime është gjashtë (6).

Neni 38 **Departamenti Ligjor**

1. Departamenti Ligjor ka për mision mbështetjen e aktiviteteve në lëminë e fushëveprimit të Agjencisë me të gjitha strukturat organizative të saj për zbatimin e legjislacionit dhe akteve normative në përputhje me rendin juridiko kushtetues, në zbatimin e legjislacionit pozitiv si dhe përfaqësimin e interesave të APK-së.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit Ligjor janë:

1.1. Ofron mbështetje në hartimin e dokumenteve strategjike dhe zbatimin e legjislacionit;

1.2. Ofron mbështetje për hartimin e procedurave dhe standardeve që kanë të bëjnë me aktivitetet e Agjencisë Pyjore të Kosovës;

1.3. Ofron mbështetje ligjore sipas kërkesës për të gjitha aktivitetet tjera të Agjencisë Pyjore të Kosovës;

1.4. Në bashkëpunim me departamentet, njësitë apo personat përgjegjës për hartimin e projekt akteve normative siguron përputhshmërinë e akteve normative të propozuara me legjislacionin e Bashkimit Evropian *acquis* si dhe me legjislacionin vendor në fuqi;

1.5. Koordinon aktivitetet me Departamentin Ligjor në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrinë e Drejtësisë për përfaqësimin e Agjencisë Pyjore të Kosovës në konteste gjyqësore;

1.6. Harton shkresa juridike si: kontrata, vendime, propozime të materialeve të ndryshme të kërkuara nga Drejtori Ekzekutiv i APK-së;

1.7. Jep opinione ligjore të kërkuara nga fushëveprimi i APK-së.

2. Drejtori i Departamentit Ligjor raporton tek Drejtori i Ekzekutiv i Agjencisë Pyjore të Kosovës.

3. Numri i të punësuarve në Departamentin Ligjor është trembëdhjetë (13).

Neni 39 **Divizioni për Mbështetje Ligjore**

1. Detyrat dhe përgjegjësit e Divizionit për Mbështetje Ligjore janë:

1.1. Përpilon ose ofron mbështetje ligjore në hartimin e propozim vendimeve nga fushëveprimi i Agjencisë;

1.2. Përpilon ose ofron mbështetje ligjore në hartimin e propozim marrëveshjeve nga fushëveprimi i agjencisë;

1.3. Përpilon vendime, marrëveshjeve, memorandume, kontrata dhe dokumente tjera të nevojshme;

1.4. Ofron mbështetje profesionale për njësitë administrative të agjencisë dhe institucioneve jashtë saj lidhur me zbatimin e legjislacionit nga fushëveprimtaria e Agjencisë;

1.5. Jep opinione ligjore, rekomandime dhe këshilla nga fushëveprimi i agjencisë;

1.6. Mirëmban regjistrin e akteve ligjore dhe nënligjore të agjencisë.

2. Udhëheqësi i Divizionit për mbështetje ligjore për punën e vet raporton tek Drejtori i Departamentit Ligjor.

3. Numri i të punësuarave në Divizionin për mbështetje ligjore është tre (3).

Neni 40 **Divizioni për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit janë:

- 1.1. Koordinon aktivitetet me të gjitha strukturat organizative të Agjencisë Pyjore të Kosovës për zbatimin e legjislacionit;
 - 1.2. Ofron mbështetje ligjore në fushën e zbatimit të legjislacionit;
 - 1.3. Identifikon problemet e zbatimit të akteve normative dhe jep propozimet për tejkalimin e tyre;
 - 1.4. Përfaqëson interesat e Agjencisë Pyjore të Kosovës dhe strukturave të saja organizative në kontestet gjyqësore;
 - 1.5. Koordinon aktivitetet e Agjencisë Pyjore të Kosovës me MBPZHR-në dhe Institucionet tjera përkatëse.
2. Udhëheqësi i Divizionit për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit për punën e vet raporton tek Drejtori i Departamentit Ligjor.
 3. Numri i të punësuarve në Divizionin për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit është nëntë (9).

Neni 41
Departamenti për Buxhet dhe
Financa

1. Departamenti për Buxhet dhe Financa ka mision të menaxhojë sipas planifikimit dhe të bëjë ekzekutimin e buxhetit në përputhje me Ligjin përkatës për Menaxhimin e Financave Publike dhe legjislacionin tjetër në fuqi.
2. Detyrat dhe përgjegjësit e Departamentit për Buxhet dhe Financa janë:
 - 2.1. Menaxhon buxhetin e Agjencisë si dhe zbaton objektivat e agjencisë;
 - 2.2. Analizon dhe vlerëson proceset dhe procedurat e brendshme dhe rekomandon ndryshime me qëllim të rritjes së efikasitetit në punë;
 - 2.3. Zhvillon dhe mbikëqyr zbatimin e procedurave standarde lidhur me buxhetin e Agjencisë;
 - 2.4. Kryen detyra tjera në pajtim me legjislacionin në fuqi.
3. Drejtori i Departamentit për Buxhet dhe Financa raporton tek Drejtori Ekzekutiv.
4. Numri i të punësuarve në Departamentin për Buxhet dhe Financa është dymbëdhjetë (12).

Neni 42
Divizioni për Buxhet

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Buxhet janë:
 - 1.1. Planifikimi i buxhetit të agjencisë;
 - 1.2. Krijimi i programeve dhe nën-programeve në bazë të kërkesave të departamenteve të agjencisë;
 - 1.3. Përgatitja e analizave buxhetore si dhe raporteve mbi shpenzimin e buxhetit;
 - 1.4. Planifikimi i buxhetit në përputhje me objektivat e agjencisë;
 - 1.5. Përgatitë raporte periodike lidhur me realizimin e buxhetit.
2. Udhëhqësi i Divizionit për Buxhet raporton tek Drejtori i Departamentit për Buxhet dhe Financa.
3. Numri i të punësuarve në Divizionin për Buxhet dhe Planifikim është tre (3).

Neni 43
Divizioni për Financa

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Financa janë:
 - 1.1. Realizon shpenzimet e buxhetit në harmoni me planet e agjencisë;
 - 1.2. Përgatitë analizat financiare si dhe shpenzimin e buxhetit;
 - 1.3. Përgatitë raporte të ndryshimeve periodike dhe vjetore;
 - 1.4. Ofron të dhëna për auditorët e brendshëm dhe të jashtëm në kryerjen e auditimeve.
2. Udhëhqësi i Divizionit për Financa, raporton tek Drejtori i Departamentit për Buxhet dhe Financa.
3. Numri i të punësuarve në Divizionin për Financa është tetë (8).

Neni 44
Departamenti i Shërbimeve të Përgjithshme

1. Departamenti i Shërbimeve të Përgjithshme ka për mision të ofrojë mbështetje administrative dhe teknike për njësitë administrative brenda Agjencisë.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit të Shërbimeve të Përgjithshme janë:

- 2.1. Menaxhon dhe koordinon ofrimin e shërbimeve të përgjithshme në pajtim me legjislacionin në fuqi;
 - 2.2. Menaxhon sistemin arkivor dhe punët e zyrës;
 - 2.3. Ofron shërbimet logjistike;
 - 2.4. Siguron dhe administron ofrimin e shërbimeve të përkthimeve;
 - 2.5. Siguron menaxhimin e pasurisë, përfshirë edhe stoqet;
 - 2.6. Kryen detyra tjera në pajtim me legjislacionin në fuqi.
3. Drejtori i Departamentit raporton tek Drejtori Ekzekutiv.
 4. Numri i të punësuarve në Departamentin e Shërbimeve të Përgjithshme është në total pesëmbëdhjetë (15).

Neni 45
Divizioni për Logjistikë dhe Shërbime

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit të Logjistikës dhe Shërbimeve janë:
 - 1.1. Siguron kushtet e punës dhe të akomodimit për stafin e Agjencisë;
 - 1.2. Menaxhon inventarin dhe depot e Agjencisë;
 - 1.3. Bën pranimin, kontrollimin e pasurisë, menaxhimin e stoqeve dhe përgatitjen e raporteve përkatëse;
 - 1.4. Përcjell lëvizjen e pasurisë dhe ofron informacione të duhura lidhur me lëvizjen e pasurisë dhe përgatit dokumentacionin për lëvizjen e pasurisë – tjetërsimit;
 - 1.5. Ofron shërbime për nevojat e Agjencisë për inventar, mallra dhe pajisje tjera të zyrës për punë;
 - 1.6. Siguron ofrimin e shërbimit të transportit dhe bën menaxhimin e veturave të Agjencisë dhe atyre që janë në shfrytëzim të saj;
 - 1.7. Ofron ndihmë logjistike mbështetëse për organizimin e takimeve të personelit të Agjencisë;
 - 1.8. Kryen dhe detyra tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi;
 - 1.9. Siguron ofrimin e shërbimeve të përkthimit në gjuhët zyrtare, nga gjuhët zyrtare në gjuhë të tjera dhe anasjelltas të dokumenteve zyrtare dhe dokumenteve të tjera të nevojshme për Ministrinë;

1.10. Ofron përkthimin simultan/ konsektiv në gjuhët zyrtare, nga gjuhët zyrtare në gjuhë të tjera dhe anasjelltas për nevojat e Agjencisë;

1.11. Ofron shërbimin e lektorimit.

2. Udhëheqësi i Divizionit të Logjistikës dhe Shërbimeve raporton tek Drejtori i Departamentit.

3. Numri i të punësuarve në kuadër të Divizionit të Logjistikës është shtatë (7).

Neni 46

Divizioni për Administrimin e Dokumenteve

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Administrimin e Dokumenteve janë:

1.1 Pranon dhe kontrollon dokumentet hyrëse dhe dalëse;

1.2. Evidenton dokumentet hyrëse dhe dalëse në librin përkatës të protokollit;

1.3. Në bashkëpunim me njësitë hartuese të shkresave vendos shenjat e klasifikimit, dhe afatin e ruajtjes të të gjitha dokumenteve;

1.4. Bën vulosjen e dokumenteve përkatëse;

1.5. Bën përpunimin final dhe vendos shkresat në arkiv;

1.6. Ofron mbështetje në asgjësimin e dokumenteve të panevojshme dhe dorëzimin e lëndës arkivore pas një afati të caktuar ligjor në Arkivin Shtetëror të Kosovës;

1.7. Bën dërgimin e dokumenteve, në procedim të mëtutjeshëm në formë fizike dhe/apo elektronike dhe organizon shpërndarjen e shkresave të Ministrisë tek institucionet tjera dhe palëve me interes;

1.8. Siguron vendosjen e dokumenteve në regjistraturë;

1.9. Siguron menaxhimin e hapësirave arkivore të Agjencisë dhe materialit arkivor, përfshirë zhvillimi i procedurave për ruajtje dhe asgjësim sipas legjislacionit në fuqi;

1.10. Siguron informimin e zyrtarëve të Agjencisë mbi procedurat administrative, pranimin, evidentimin, shpërndarjen e dokumenteve zyrtare për klasifikimin dhe ruajtjen e tyre;

1.11. Kryen dhe detyra tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

2. Udhëheqësi i Divizionit për Administrimin e Dokumenteve raporton tek Drejtori i Departamentit.

3. Numri i të punësuarve në kuadër të Divizionit për Administrimin e Dokumenteve është katër (4).

Neni 47
Divizioni për Teknologji Informative

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për TI janë:

1.1. Udhëheqë dhe cakton objektivat e tij në pajtim me strategjinë e APK-së dhe ASHI-së si dhe harton planet e punës vjetore të detajuara,

1.2. Ofron udhëzime profesionale në përdorimin e paisjeve të TI-së për të siguruar shërbime cilësore;

1.3. Bën mirëmbajtjen e pajisjeve dhe softwer-ve të teknologjisë informative;

1.4. Koordinon aktivitetet në fushën e TI-së me ASHI;

1.5. Menaxhon dhe Administron E-Mailin Qeveritar për APK-në, Menaxhimi i domenit/llogarive zyrtare gov.irk.rks, konfigurimi, hapja, bartja, vazhdimi i llogarive zyrtare të APK-së;

1.6. Bën menaxhimin e licencave të programeve softuerike të Microsoft-it dhe Antivirusit për APK-në;

1.7. Planifikon, menaxhon, monitoron të gjitha proceset që kanë të bëjnë me TI-në në zbatimin e Qeverisjes në tërësi në APK;

1.8. Në koordinim me ASHI-në administron dhe mirëmban SIPK, web faqen e APK-së dhe rrjeteve sociale;

1.9. Përgatitë dhe procedon kërkesat për furnizim me paisje të TI-së;

2. Udhëheqësi i Divizionit për Teknologji Informative raporton tek Drejtori i Departamentit për Shërbime të Përgjithshme.

3. Numri i të punësuarve në Divizionin për TI-së është tre (3).

Neni 48
Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

1. Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore është njësi organizative në kuadër të APK-së, i cili ka për mision të sigurojë menaxhimin efektiv të burimeve njerëzore përmes zhvillimit të procedurave, programeve dhe shërbimeve që kontribuojnë në arritjen e qëllimeve të Institucionit dhe punonjësve duke bërë balancimin e duhur të nevojave të punonjësve dhe nevojave të institucionit;

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore janë:

- 2.1. Mbështetja dhe ofrimi i këshillave për udhëheqësin më të lartë administrativ të institucionit për fushën e burimeve njerëzore;
 - 2.2. Përgatitja e Planit vjetor të personelit, në përputhje me procesin e planifikimit buxhetor të institucionit;
 - 2.3. Ofron ndihmë për njësitë përkatëse në përgatitjen e përshkrimeve, klasifikimin dhe Sistematizimin e vendeve të punës;
 - 2.4. Zhvillimi i procedurave të rekrutimit për zyrtarët publik deri në plotësimin e vendit të punës në bazë të legjislacionit në fuqi;
 - 2.5. Në bashkërendim me udhëheqësit e njërive identifikon dhe vlerëson në mënyrë periodike, nevojat për aftësimin e nëpunësve civil të institucionit për aftësimin dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale përmes trajnimit për zhvillim në karrierë;
 - 2.6. Menaxhimi i procedurave të Burimeve Njerëzore që lidhen me disiplinën emërimet, lirimet, transferimet, pezullimet, pensionimin dhe aktivitetet tjera në kuptimin e ligjit përkatës për zyrtarët publikë si dhe mbajtja e raportit vjetor mbi Menaxhimin e Burimeve Njerëzore;
 - 2.7. Mbështetë procedurën për vlerësim të performancës, rekomandon transferimin e nëpunësit civil, si dhe menaxhon praraqitjen në punë të zyrtarëve publikë në institucion;
 - 2.8. Administron planet dhe dosjet e personelit (dosje individuale-fizike), si dhe përmes platformës elektronike- Sistemit informativ për menaxhimin e burimeve njerëzore (SIMBNJ).
3. Udhëheqësi i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore raporton tek Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Pyjore të Kosovës.
 4. Numri i të punësuarve në Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore është tre (3).

Neni 49 **Divizioni i Prokurimit**

1. Divizioni për Prokurim ka për mision zhvillimin e procedurave të prokurimit për arritjen e vlerës së parashë në përputhje me parimet e përcaktuara me ligjin përkatës për prokurimin publik.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit të Prokurimit janë:
 - 2.1. Përgatitë, koordinon dhe zbaton planin vjetor të Agjencisë Pyjore të Kosovës në fushën e prokurimit publik;
 - 2.2. Siguron që mallrat, shërbimet dhe punët blihen në mënyrën më ekonomike, efektive dhe efektive;

- 2.3. Këshillon njësitë kërkuese, për metoda dhe praktika përkatëse të prokurimit;
 - 2.4. Organizon dhe menaxhon aktivitetet e prokurimit. Përcakton metodologjinë e prokurimit për tender dhe procedurat e vlerësimit të çmimeve;
 - 2.5. Pranon/refuzon rekomandimin e propozuar. Nënshkruan kontratat pas rikonfirmimit që informatat financiare nuk kanë ndryshuar substancialisht;
 - 2.6. Ofron mbështetje menaxhmentit në marrjen e vendimeve lidhur me çështjet kontestuese që mund të dalin në rastet e ekzekutimit të kontratave;
 - 2.7. Përcjellë dështimet e kontraktorëve të cilët kanë dështuar të përmbushin obligimet e tyre kontraktuale kurdo që informohet nga Menaxheri i Projektit në lidhje me kompensimet e duhura, likuidimin e dëmeve dhe aranzhimin e anulimit të kontratave;
 - 2.8. Harton një raport vjetor në fund të secilit vit fiskal për kontratat e nënshkuara
3. Udhëheqësi i Divizionit të Prokurimit raporton tek Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Pyjore të Kosovës.
 4. Numri i të punësuarve në Divizionin e Prokurimit është tre (3).

Neni 50

Njësia e Auditimit të Brendshëm

1. Njësia e Auditimit të Brendshëm ka për mision të ofrojë shërbime të pavarura, objektive, siguroese dhe këshillëdhënëse të dizajnuara që të shtojnë vlerën dhe të përmirësojnë funksionimin e Agjencisë duke iu ndihmuar që të arrijnë objektivat e tyre dhe sjelljen e një qasjeje sistematike dhe të disiplinuar për të vlerësuar dhe përmirësuar efektivitetin e proceseve të menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe qeverisjes.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e njësisë së auditimit të brendshëm janë:
 - 2.1. Siguron zbatimin adekuat dhe respektimin e ligjeve, rregullave, politikave, udhëzimeve dhe doracakëve të përcaktuar me legjislacionin në fuqi.
 - 2.2. Siguron përgatitjen me kohë të propozim-planit strategjik dhe vjetor të auditimit në bazë të vlerësimit të rrezikut;
 - 2.3. Organizon, kryen dhe mbikëqyrë të gjitha aktivitetet e auditimit të brendshëm për Agjencinë Pyjore të Kosovës dhe dorëzon rezultatet e auditimit në pajtim me legjislacionin në fuqi;
 - 2.4. Përgatitë dhe dorëzon raportet gjashtë mujore dhe vjetore për të gjitha aktivitetet e auditimit në NJQH/AB - Ministria e financave;

2.5. Përgatitë dhe zbaton programin e sigurisë së cilësisë për vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm të funksionimit të auditimit të brendshëm;

2.6. Përmes auditimeve të brendshme promovon llogaridhënie, transparencë dhe paanshmëri duke synuar përmirësim të performancës, transparencës dhe efikasitetit në përmbushjen e objektivave dhe obligimeve në sektorët përkatës në APK-së NJAB raporton menjëherë tek menaxhmenti i lartë dhe komiteti i auditimit për çdo indikator të aktivitetit të mashtrimit apo korrupsionit, ofron këshilla, propozime, rekomandime për përmirësimin e gjendjes si dhe nëse menaxhmenti i lartë nuk ndërmer veprimet e duhura, NJAB njofton autoritetet tjera kompetente;

2.7. Njësia e Auditimit të Brendshëm merr informata pa kufizime dhe pa pengesë nga thesari, banka qendrore e Kosovës dhe cila do organizatë publike, buxhetore apo private në lidhje me xhirollogaritë ose transaksionet ekonomike aktuale ose të mbyllura që janë përfshirë me subjektin APK-në nën Auditim;

3. Udhëheqësi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm për punën raporton nga ana funksionale Ministrin, ndërsa nga ana administrative Drejtorit Ekzekutiv;

4. Numri i të punësuarve në Njësinë e Auditimit të Brendshëm është tre (3).

KAPITULLI IV DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 51 Dispozitat Kalimtare

1. Rritja apo zvogëlimi i numrit të personelit në pajtim me Ligjin vjetor të Buxhetit, nuk krijon nevojë për plotësim ndryshimin e kësaj Rregulloreje, përpos në rastet kur krijohen dhe/apo shuhen strukturat organizative;

2. Pjesë e kësaj Rregulloreje është Shtojca Struktura Organizative e Agjencisë Pyjore të Kosovës.

Neni 52 Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja QRK-Nr. 16/2014 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Pyjore të Kosovës.

Neni 53
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

5 Mars 2025

Organogrami i Agjencisë Pyjore të Kosovës

Pozicioni/Struktura	Klasa	Grupi i përgjithshëm ose i veçantë Emri i Grupit Tip	Numri
1.ZYRA E DREJTORIT EKZEKUTIV -Drejtor Ekzekutiv i APK-së; -Zyrtar Administrativ -Ngasës (Shofer); -Zyrtari i Lartë Certifikues; -Zyrtar i lartë për komunikim me publikun;	Drejtues i Lartë Profesional 2 Nëpunës mbështetës Profesional 1 Profesional 1	63. Grupi i administrimit të përgjithshëm 3. Grupi i ekonomisë 8. Grupi i marrëdhënieve me publikun dhe informimin	Gjithsej: 5 1 1 1 1
2.DEPARTAMENTI PËR MENAXHIM ME PYJE -Drejtor i Departamentit për Menaxhim me Pyje	Drejtues i mesëm		Gjithsej: 1 1
2.1.Divizioni për Inventarizim, Plane Menaxhuese dhe Kadastër Pyjor: -Udhëheqësi i Divizionit për Inventarizim, Plane Menaxhuese dhe Kadastër Pyjor; -Zyrtar i lartë për Inventarizim dhe Plane Menaxhuese -Zyrtar i lartë për kadaster pyjor	Drejtues i Ulët Specialist Specialist	30. Grupi i bujqësisë, pyjeve dhe tokës 43. Grupi i hartografisë dhe GIS	Gjithsejt: 3 1 1 1

<p>2.2. Divizioni për Planifikim, Shfrytëzim dhe Kultivim të Pyjeve;</p> <p>-Udhëheqësi i Divizionit për Planifikim, Shfrytëzim dhe Kultivim të Pyjeve</p> <p>-Zyrtar i lartë për Planifikim, Shfrytëzim dhe Kultivim të Pyjeve;</p> <p>-Zyrtar i Lartë për Planifikim dhe Shfrytëzim të Prodhimeve jo drunore</p>	<p>Drejtues i Ulët</p> <p>Specialist</p> <p>Specialist</p>	<p>30. Grupi i bujqësisë, pyjeve dhe tokës</p> <p>30. Grupi i bujqësisë, pyjeve dhe tokës</p>	<p>Gjithsej:5</p> <p>1</p> <p>2</p> <p>2</p>
<p>2.3.Divizioni për Menaxhimin e Informatave dhe të Dhënave Statistikore në Pylltari:</p> <p>-Udhëheqësi i Divizionit për Menaxhimin e Informatave dhe të Dhënave Statistikore në Pylltari;</p> <p>-Zyrtar i lartë për Sistemin informative të Pyjeve</p> <p>-Zyrtar i lartë për informacione dhe të dhëna statistikore për pylltari</p>	<p>Drejtues i Ulët</p> <p>Profesional 1</p> <p>Profesional 1</p>	<p>49. Grupi i teknologjisë informative</p> <p>27. Grupi i statistikës</p>	<p>Gjithsej: 3</p> <p>1</p> <p>1</p> <p>1</p>
<p>3.DEPARTAMENTI PËR MENAXHIMIN ME VEND GJUETI ME RËNDËSI TË VEÇANTA DHE KULTIVIMIN E KAFSHËVE TË EGRA</p> <p>-Drejtor i Departamentit për Menaxhimin me Vend gjueti me Rëndësi të Veçanta dhe Kultivimin e Kafshëve të Egra</p>	<p>Drejtues i Mesëm</p>		<p>Gjithsej: 1</p> <p>1</p>

<p>3.1. Divizioni për Menaxhimin e Vend Gjuetive me Rëndësi të Veçanta: -Udhëheqës i Divizionit për Menaxhimin e Vend Gjuetive me Rëndësi të Veçanta -Zyrtar i lartë për Gjueti -Asistent për Pyje, Gjahu dhe Peshkim -Zyrtar administrativ -Roje Pylli, Gjahu dhe Peshkimi</p>	<p>Drejtues i Ulët Specialist Profesional 3 Profesional 2 Nëpunës teknik dhe mbështetës</p>	<p>11. Grupi i shkencave natyrore 64. Grupi i administrimit të përgjithshëm 63. Grupi i administrimit të përgjithshëm</p>	<p>Gjithsej: 25 1 2 4 1 17</p>
<p>3.2. Divizioni për Kultivimin e Kafshëve të Egra: -Udhëheqës i Divizionit për Kultivimin e Kafshëve të Egra - Zyrtar për kultivim të kafshëve të egra</p>	<p>Drejtues i Ulët Profesional 2</p>	<p>11. Grupi i shkencave natyrore</p>	<p>Gjithsej:3 1 2</p>
<p>4.DEPARTAMENTI REGJIONAL I APK NË PRISHTINË</p>	<p>Drejtues i Mesëm</p>		<p>Gjithsej:1 1</p>

-Drejtor i Departamentit Regjional i APK-së			
4.1.Divizioni për Mbrojtje dhe Ruajtje të Pyjeve;			Gjithsej: 44
-Udhëheqës i Divizionit për Mbrojtje dhe Ruajtje të Pyjeve	Drejtues i Ulët		1
-Zyrtar i lartë për mbrojtje dhe ruajtje të pyjeve	Profesional 1	63. Grupi i administrimit të përgjithshëm	5
-Zyrtar i lartë për Pylltari	Specialist	30.Grupi i bujqësisë, pyjeve dhe tokës	1
-Asistent administrativ	Profesional 3	64. Grupi i administrimit të përgjithshëm	1
-Asistent për Mbrojtje të pyjeve	Profesional 3	64. Grupi i administrimit të përgjithshëm	1
-Asistent për Ruajtje të Pyjeve	Profesional 3	64. Grupi i administrimit të përgjithshëm	1
-Teknik I Pylltarisë	Nëpunës Teknik dhe mbështetës		1
-Roje Pylli	Nëpunës Teknik dhe mbështetës		32
-Roje objekti	Nëpunës Teknik dhe mbështetës		1
4.2.Divizioni për Produktet Drunore, Jo drunore dhe Funkzionet tjera të Pyllit;			Gjithsej:5
-Udhëheqës i Divizionit për Produktet Drunore, Jodrunore dhe Funkzionet tjera të Pyllit;	Drejtues i Ulët		1
-Zyrtar i lartë për Pylltari	Specialist	30.Grupi i bujqësisë, pyjeve dhe tokës	2

-Zyrtar për Pyje	Profesional 3	64.Grupi i administrimit të përgjithshëm	2
4.3.Divizioni për Ripërtrirje, Pyllëzime, Kullota dhe Këshillime: -Udhëheqës I Divizionit për Ripërtrirje, Pyllëzime, Kullota dhe Këshillime;	Drejtues i Ulët		Gjithsej: 5 1
-Zyrtar i lartë për Pylltari -Zyrtar i lartë për Kullota	Specialist Specialist Profesional 3	30.Grupi i bujqësisë, pyjeve dhe tokës 30. Grupi i bujqësisë, pyjeve dhe tokës	1 1
-Asistent I Pylltarisë		64. Grupi i administrimit të përgjithshëm	2
5.DEPARTAMENTI REGJIONAL I APK NË MITROVICË			Gjithsej:1
-Drejtor i Departamentit Regjional i APK-së	Drejtues i Mesëm		1
5.1.Divizioni për Mbrojtje dhe Ruajtje të Pyjeve;			Gjithsej: 45
-Udhëheqës i Divizionit për Mbrojtje dhe Ruajtje të Pyjeve	Drejtues i Ulët		1
-Zyrtar i lartë për mbrojtje dhe ruajtje të pyjeve		63. Grupi i administrimit të përgjithshëm	6 1
-Zyrtar i lartë për Pylltari	Profesional 1	30.Grupi i bujqësisë, pyjeve dhe tokës	1
-Asistent administrativ	Specialit	64. Grupi i administrimit të përgjithshëm	1
-Asistent për Mbrojtje të pyjeve	Profesional 3	64. Grupi i administrimit të përgjithshëm	1
-Asistent për Ruajtje të Pyjeve	Profesional 3 Profesional 3	64. Grupi i administrimit të përgjithshëm	1
-Teknik I Pylltarisë			1

-Roje Pylli	Nëpunës Teknik dhe mbështetës		32
-Roje objekti	Nëpunës Teknik dhe mbështetës Nëpunës Teknik dhe mbështetës		1
5.2.Divizioni për Produktet Drunore, Jo drunore dhe Funkcionet tjera të Pyllit; -Udhëheqës i Divizionit për Produktet Drunore, Jodrunore dhe Funkcionet tjera të Pyllit; -Zyrtar i lartë për Pylltari - Asistent i Pylltarisë	Drejtues i Ulët Specialist Profesional 3	30.Grupi i bujqësisë, pyjeve dhe tokës 64.Grupi i administrimit të përgjithshëm	Gjithsej:5 1 2 2
5.3.Divizioni për Ripërtrirje, Pyllëzime, Kullota dhe Këshillime: -Udhëheqës I Divizionit për Ripërtrirje, Pyllëzime, Kullota dhe Këshillime -Zyrtar i lartë për Pylltari -Zyrtar i lartë për Kullota - Asistent i Pylltarisë	Drejtues i Ulët Specialist Specialist Profesional 3	30.Grupi i bujqësisë, pyjeve dhe tokës 30. Grupi i bujqësisë, pyjeve dhe tokës 64. Grupi i administrimit të përgjithshëm	Gjithsej: 5 1 1 1 2
6.DEPARTAMENTI REGJIONAL I APK NË PEJË -Drejtor i Departamentit Regjional i APK-së	Drejtues i Mesëm		Gjithsej:1 1

<p>6.1.Divizioni për Mbrojtje dhe Ruajtje të Pyjeve;</p> <p>-Udhëheqës i Divizionit për Mbrojtje dhe Ruajtje të Pyjeve</p> <p>-Zyrtar i lartë për mbrojtje dhe ruajtje të pyjeve</p> <p>-Zyrtar i lartë për Pylltari</p> <p>-Asistent administrativ</p> <p>-Asistent për Mbrojtje të pyjeve</p> <p>-Asistent për Ruajtje të Pyjeve</p> <p>-Teknik I Pylltarisë</p> <p>-Roje Pylli</p>	<p>Drejtues i Ulët</p> <p>Profesional 1 Specialist</p> <p>Profesional 3</p> <p>Profesional 3</p> <p>Profesional 3</p> <p>Nëpunës Teknik dhe mbështetës</p> <p>Nëpunës Teknik dhe mbështetës</p>	<p>63. Grupi i administrimit të përgjithshëm</p> <p>30.Grupi i bujqësisë, pyjeve dhe tokës</p> <p>64. Grupi i administrimit të përgjithshëm</p> <p>64. Grupi i administrimit të përgjithshëm</p> <p>64. Grupi i administrimit të përgjithshëm</p>	<p>Gjithsej: 40</p> <p>1</p> <p>6</p> <p>1</p> <p>1</p> <p>1</p> <p>1</p> <p>1</p> <p>1</p> <p>28</p>
<p>6.2.Divizioni për Produktet Drunore, Jo drunore dhe Funkzionet tjera të Pyllit;</p> <p>-Udhëheqës i Divizionit për Produktet Drunore, Jodrunore dhe Funkzionet tjera të Pyllit;</p> <p>-Zyrtar i lartë për Pylltari</p> <p>- Asistent i Pylltarisë</p>	<p>Drejtues i Ulët</p> <p>Specialist</p> <p>Profesional 3</p>	<p>30.Grupi i bujqësisë, pyjeve dhe tokës</p> <p>64.Grupi i administrimit të përgjithshëm</p>	<p>Gjithsej:5</p> <p>1</p> <p>2</p> <p>2</p>

6.3.Divizioni për Ripërtrirje, Pyllëzime, Kullota dhe Këshillime: -Udhëheqës I Divizionit për Ripërtrirje, Pyllëzime, Kullota dhe Këshillime -Zyrtar i lartë për Pylltari -Zyrtar i lartë për Kullota - Asistent i Pylltarisë	Drejtues i Ulët Specialist Specialist Profesional 3	30.Grupi i bujqësisë, pyjeve dhe tokës 30. Grupi i bujqësisë, pyjeve dhe tokës 64. Grupi i administrimit të përgjithshëm	Gjithsej: 5 1 1 1 2
7.DEPARTAMENTI REGJIONAL I APK NË FERIZAJ -Drejtor i Departamentit Regjional i APK-së	Drejtues i Mesëm		Gjithsej:1 1
7.1.Divizioni për Mbrojtje dhe Ruajtje të Pyjeve; -Udhëheqës i Divizionit për Mbrojtje dhe Ruajtje të Pyjeve -Zyrtar i lartë për mbrojtje dhe ruajtje të pyjeve -Zyrtar i lartë për Pylltari -Asistent Administrativ -Asistent për Mbrojtje të pyjeve -Asistent për Ruajtje të Pyjeve -Teknik I Pylltarisë -Roje Pylli -Pastrues/e	Drejtues i Ulët Profesional 1 Specialist Profesional 3 Profesional 3 Profesional 3 Nëpunës Teknik dhe mbështetës Nëpunës Teknik dhe mbështetës	63. Grupi i administrimit të përgjithshëm 30. Grupi i bujqësisë, pyjeve dhe tokës 64. Grupi i administrimit të përgjithshëm 64. Grupi i administrimit të përgjithshëm 64. Grupi i administrimit të përgjithshëm	Gjithsej: 40 1 5 1 1 1 1 1 28 1

	Nëpunës Teknik dhe mbështetës		
7.2.Divizioni për Produktet Drunore, Jo drunore dhe Funkzionet tjera të Pyllit; -Udhëheqës i Divizionit për Produktet Drunore, Jodrunore dhe Funkzionet tjera të Pyllit; -Zyrtar i lartë për Pylltari - Asistent i Pylltarisë	Drejtues i Ulët Specialist Profesional 3	30.Grupi i bujqësisë, pyjeve dhe tokës 64.Grupi i administrimit të përgjithshëm	Gjithsej:5 1 2 2
7.3.Divizioni për Ripërtrirje, Pyllëzime, Kullota dhe Këshillime: -Udhëheqës I Divizionit për Ripërtrirje, Pyllëzime, Kullota dhe Këshillime -Zyrtar i lartë për Pylltari -Zyrtar i lartë për Kullota -Asistent i Pylltarisë	Drejtues i Ulët Specialist Specialist Profesional 3	30.Grupi i bujqësisë, pyjeve dhe tokës 30. Grupi i bujqësisë, pyjeve dhe tokës 64. Grupi i administrimit të përgjithshëm	Gjithsej: 5 1 1 1 2
8.DEPARTAMENTI REGJIONAL I APK NË PRIZREN -Drejtor i Departamentit Regjional i APK-së	Drejtues i Mesëm		Gjithsej:1 1

<p>8.1.Divizioni për Mbrojtje dhe Ruajtje të Pyjeve;</p> <p>-Udhëheqës i Divizionit për Mbrojtje dhe Ruajtje të Pyjeve</p> <p>-Zyrtar i lartë për mbrojtje dhe ruajtje të pyjeve</p> <p>-Zyrtar i lartë për Pylltari</p> <p>-Asistent Administrativ</p> <p>-Asistent për Mbrojtje të pyjeve</p> <p>-Asistent për Ruajtje të Pyjeve</p> <p>-Teknik i Pylltarisë</p> <p>-Roje Pylli</p> <p>-Roje objekti</p> <p>-Pastrue/e</p>	<p>Drejtues i Ulët</p> <p>Profesional 1</p> <p>Specialist</p> <p>Profesional 3</p> <p>Profesional 3</p> <p>Profesional 3</p> <p>Nëpunës Teknik dhe mbështetës</p> <p>Nëpunës Teknik dhe mbështetës</p> <p>Nëpunës Teknik dhe mbështetës</p> <p>Nëpunës Teknik dhe mbështetës</p>	<p>63. Grupi i administrimit të përgjithshëm</p> <p>30. Grupi i bujqësisë, pyjeve dhe tokës</p> <p>64. Grupi i administrimit të përgjithshëm</p> <p>64. Grupi i administrimit të përgjithshëm</p> <p>64. Grupi i administrimit të përgjithshëm</p>	<p>Gjithsej: 45</p> <p>1</p> <p>5</p> <p>1</p> <p>1</p> <p>1</p> <p>1</p> <p>1</p> <p>32</p> <p>1</p> <p>1</p>
<p>8.2.Divizioni për Produktet Drunore, Jo drunore dhe Funkcionet tjera të Pyllit;</p> <p>-Udhëheqës i Divizionit për Produktet Drunore, Jodrunore dhe Funkcionet tjera të Pyllit;</p> <p>-Zyrtar i lartë për Pylltari</p> <p>-Asistent i Pylltarisë</p>	<p>Drejtues i Ulët</p> <p>Specialist</p> <p>Profesional 3</p>	<p>30. Grupi i bujqësisë, pyjeve dhe tokës</p> <p>64. Grupi i administrimit të përgjithshëm</p>	<p>Gjithsej:5</p> <p>1</p> <p>2</p> <p>2</p>

<p>8.3.Divizioni për Ripërtrirje, Pyllëzime, Kullota dhe Këshillime: -Udhëheqës I Divizionit për Ripërtrirje, Pyllëzime, Kullota dhe Këshillime</p> <p>-Zyrtar i lartë për Pylltari -Zyrtar i lartë për Kullota - Asistent i Pylltarisë</p>	<p>Drejtues i Ulët</p> <p>Specialist</p> <p>Specialist</p> <p>Profesional 3</p>	<p>30.Grupi i bujqësisë, pyjeve dhe tokës</p> <p>30. Grupi i bujqësisë, pyjeve dhe tokës</p> <p>64. Grupi i administrimit të përgjithshëm</p>	<p>Gjithsej: 5</p> <p>1</p> <p>1</p> <p>1</p> <p>2</p>
<p>9.DEPARTAMENTI REGJIONAL I APK NË GJILAN Drejtor i Departamentit Regjional i APK</p>	<p>Drejtues i Mesëm</p>		<p>Gjithsej:1</p> <p>1</p>
<p>9.1.Divizioni për Mbrojtje dhe Ruajtje të Pyjeve;</p> <p>-Udhëheqës i Divizionit për Mbrojtje dhe Ruajtje të Pyjeve</p> <p>-Zyrtar i lartë për mbrojtje dhe ruajtje të pyjeve</p> <p>-Zyrtar i lartë për Pylltari</p> <p>-Asistent administrativ</p> <p>-Asistent për Mbrojtje të pyjeve</p> <p>-Asistent për Ruajtje të Pyjeve</p> <p>-Teknik I Pylltarisë</p>	<p>Drejtues i Ulët</p> <p>Profesional 1</p> <p>Specialist</p> <p>Profesional 3</p> <p>Profesional 3</p> <p>Profesional 3</p>	<p>63. Grupi i administrimit të përgjithshëm</p> <p>30. Grupi i bujqësisë, pyjeve dhe tokës</p> <p>64. Grupi i administrimit të përgjithshëm</p> <p>64. Grupi i administrimit të përgjithshëm</p> <p>64. Grupi i administrimit të përgjithshëm</p>	<p>Gjithsej: 45</p> <p>1</p> <p>5</p> <p>1</p> <p>1</p> <p>1</p> <p>1</p> <p>1</p>

-Roje Pylli	Nëpunës Teknik dhe mbështetës		33
-Pastrue/e	Nëpunës Teknik dhe mbështetës		1
	Nëpunës Teknik dhe mbështetës		
9.2.Divizioni për Produktet Drunore, Jo drunore dhe Funkzionet tjera të Pyllit;			Gjithsej:5
-Udhëheqës i Divizionit për Produktet Drunore, Jodrunore dhe Funkzionet tjera të Pyllit;	Drejtues i Ulët		1
-Zyrtar i lartë për Pylltari	Specialist	30.Grupi i bujqësisë, pyjeve dhe tokës	2
-Asistent i Pylltarisë	Profesional 3	64.Grupi i administrimit të përgjithshëm	2
9.3.Divizioni për Ripërtrirje, Pyllëzime, Kullota dhe Këshillime:			Gjithsej: 5
-Udhëheqës i Divizionit për Ripërtrirje, Pyllëzime, Kullota dhe Këshillime	Drejtues i Ulët		1
-Zyrtar i lartë për Pylltari	Specialist	30.Grupi i bujqësisë, pyjeve dhe tokës	1
-Zyrtar i lartë për Kullota	Specialist	30. Grupi i bujqësisë, pyjeve dhe tokës	1
-Asistent i Pylltarisë	Profesional 3	64. Grupi i administrimit të përgjithshëm	2
10.DEPARTAMENTI LIGJOR			Gjithsej: 1
-Drejtor i Departamentit Ligjor			

	Drejtues i Mesëm		1
10.1.Divizioni për Mbështetje Ligjore: -Udhëheqës i Divizionit për mbështetje ligjore -Zyrtar i Lartë Ligjor	Drejtues i Ulët Profesional 1	1. Grupi ligjor	Gjithsej: 3 1 2
10.2.Divizioni për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit: -Udhëheqës i Divizionit për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit -Zyrtar i Lartë Ligjor -Zyrtar Administrativ	Drejtues i ulët Profesional 1 Profesional 2	1. Grupi ligjor 63. Grupi i administrimit të përgjithshëm	Gjithsej: 9 1 7 1
11.DEPARTAMENTI PËR BUXHET DHE FINANCA -Drejtor i Departamentit për Buxhet dhe Financa	Drejtues i mesëm		Gjithsej: 1 1
11.1.Divizioni për Buxhet: -Udhëheqës i Divizionit për Buxhet -Zyrtar i Lartë për Buxhet -Zyrtar për Zotimin e Mjeteve Buxhetore	Drejtues i ulët Profesional 1 Profesional 2	2.Grupi i buxhetit dhe financave 2. Grupi i buxhetit dhe financave	Gjithsej: 3 1 1 1
11.2. Divizioni për Financa: -Udhëheqës i Divizionit për Financa	Drejtues i ulët		Gjithsej:8 1

-Zyrtar i Lartë për Financa -Zyrtar i Lartë për qështje ekonomike	Profesional 1 Profesional 1	2. Grupi i buxhetit dhe financave 3. Grupi i ekonomisë	1 6
12. DEPARTAMENTI I SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME -Drejtor i Departamentit	Drejtues i Mesëm		Gjithsej: 1 1
12.1. Divizioni për Logjistikë dhe Shërbime -Udhëheqësi i Divizionit për Logjistikë dhe Shërbime -Zyrtar për Logjistikë -Zyrtar për përkthime - Zyrtar i Pasurisë -Asistent për Depo -Shofer kamioni -Pastrues/e -Roje Objekti	Drejtues i Ulët Profesional 2 Profesional 2 Profesional 2 Profesional 3 Nëpunës mbështetës dhe Teknik Nëpunës mbështetës dhe Teknik Nëpunës mbështetës dhe teknik	63. Grupi i administrimit të përgjithshëm 59. Grupi i përkthimit dhe interpretimit 3. Grupi i ekonomisë 63. Grupi i administrimit të përgjithshëm	Gjithsej: 8 1 1 1 1 1 1 1
12.2. Divizioni për Administrimin e Dokumenteve -Udhëheqës i Divizionit për Administrimin e Dokumenteve	Drejtues i ulët		Gjithsej: 4 1

-Zyrtar për administrimin e dokumenteve	Profesional 2	2. Grupi i arkiv- dokumentacionit	1
-Zyrtar për arhivë	Profesional 2	7. Grupi i arkiv- dokumentacionit	2
12.3.Divizioni për Teknologji Informativ Udhëheqës i Divizionit për Teknologji Informativ - Zyrtar i lartë i TI -së	Drejtues i ulët Profesional 1	49. Grupi i teknologjisë informative	Gjithsej: 3 1 2
13. NJËSIA PËR MENAXHIMIN E BURIMEVE NJERËZORE: - Udhëheqësi/ja i/e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore; - Zyrtar i lartë për Burime Njerëzore	Drejtues I Ulët Profesional 1	6. Grupi i burimeve njerëzore	Gjithsej: 3 1 2
14.DIVIZIONI I PROKURIMIT: -Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit -Zyrtar i Lartë I Prokurimit	Drejtues i Ulët Profesional 1	4. Grupi i prokurimit publik	Gjithsej: 3 1 2
15.NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM: -Udhëheqësi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm -Auditor i Brendshëm	Drejtues i Ulët Profesional 1	5. Grupi i auditimit të brendshëm	Gjithsej: 3 1 2
Totali i numrit të përgjithshëm:			421

